

PPSH UDHËHEQ ME VENDOSMËRI POPULLIN NË RRUGËN MARKSISTE-LENINISTE TË NDËRTIMIT TË PLOTË TË SHOQËRISË SOCIALISTE

(1976-1980)

1. KONGRESI VII I PARTISË — SINTEZË MARKSISTE- -LENINISTE E MENDIMIT DHE E VEPRIMIT REVOLUCIONAR

Kongresi VII i PPSH u mbajt në Tiranë nga 1 deri më 7 nëntor 1976. Ndër 843 delegatët e tij, 734 qenë me votë deliberative, 109 me votë konsultative. Ata përfaqësonin 88 000 anëtarë dhe 13 500 kandidatë partie.

Raporti mbi veprimtarinë e KQ që mbajti shoku Enver Hoxha, raporti mbi direktivat e planit të 6-të pesëvjeçar që mbajti shoku , diskutimet e delegatëve dhe vendimet e Kongresit përbënin një sintezë marksiste-leniniste të mendimit dhe të veprimit revolucionar të Partisë. Detyrat që përcaktoi dhe direktivat e planit të 6-të pesëvjeçar që miratoi Kongresi hapën perspektiva të reja në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në Shqipëri.

Kushtetuta e RPSSH — vepër e Partisë dhe e popullit

Si çështje të parë Kongresi shqyrtoi Kushtetutën e re të Shqipërisë socialiste.

Në bazë të vendimit të Kongresit VI të Partisë, Komiteti Qendror kishte marrë të gjitha masat për të kryer studimet e nevojshme dhe për të hartuar projektin e këtij ligji themelor.

Komisionin e hartimit të Projektkushtetutës e drejtonte shoku Enver Hoxha.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Kuvendi Popullor ia shtruan Projektkushtetutën për diskutim popullit në gjashtëmujorin e parë të vitit 1976. Diskutimi u shndërrua në një aksion të madh popullor, politik e ideologjik. Në mbledhje morën pjesë 1 500 000 njerëz, domethënë gjithë popullsia e rritur e vendit. Për çështje të ndryshme të projektit folën 300 000 vetë. Vërejtjet e propozimet shumë të vlefshme të punonjësve u pasqyruan në ripunimin e tij. Masat popullore miratuan njëzëri brendinë e Projektkushtetutës, që do të thotë miratuan vijën e përgjithshme të PPSH, rrugën revolucionare të ndjekur prej saj.

Kushtetuta e re shënon një zhvillim të mëtejshëm cilësor të shtetit socialist shqiptar në përshtatje me etapën e re të revolucionit — të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në të mishërohen shndërrimet e mëdha revolucionare të arritura nga populli shqiptar nën udhëheqjen e PPSH si edhe e reja që i ka sjellë Partia me shokun Enver Hoxha teorisë e praktikës së socializmit shkencor.

Në Kushtetutën e re shteti shqiptar emërtohet **Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë (RPSSH)**. Ky emërtim pasqyron më saktë ndryshimet cilësore socialiste të realizuara në bazën e superstrukturën e shoqërisë, në të njëjtën kohë ruan edhe traditën.

Kongresi nënvizoi karakterin e hapur klasor të Kushtetutës.

Këtë karakter Kushtetuta e shprehu:

duke shpallur e sanksionuar RPSSH shtet të diktaturës së proletariatit dhe udhëheqjen e klasës punëtore në të gjithë jetën e vendit;

duke përcaktuar Partinë e Punës të Shqipërisë, pararojë të klasës punëtore, forcën e vetme politike udhëheqëse të shtetit e të shoqërisë;

duke ligjësuar marksizëm-leninizmin Ideologji sunduese, në bazë të së cilës zhvillohet gjithë rendi shoqëror socialist;

duke e cilësuar luftën e klasave forcën e madhe lëvizëse për ta çuar përpara revolucionin socialist, nëpërmjet të cilit do të sigurohet fitorja përfundimtare e rrugës socialiste, ndërtimi i plotë i socializmit dhe i komunizmit.

Në të njëjtën kohë Kongresi u ndal në karakterin thellësisht demokratik popullor të shtetit shqiptar të diktaturës së proletariatis dhe në humanizmin e vërtetë socialist, që mishërohen në Kushtetutë në mënyrë të qartë e të plotë. «*Diktatura e proletariatis*, — tha shoku Enver Hoxha në raport, — është e pandarë nga demokracia më e gjerë, më e thellë e më e plotë për punonjësit»¹.

Kjo demokraci më e gjerë për punonjësit gjen shprehjen në nenin e Kushtetutës: «I gjithë pushteti shtetëror në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë buron nga populli punonjës dhe i përket atij», si edhe në një varg nenesh të tjera.

Demokracia socialiste u ka siguruar klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste dhe punonjësve të tjerë të ushtrojnë pushtetin si nëpërmjet organeve përfaqësuese, ashtu edhe drejtpërsëdrejti, të marrin pjesë efektivisht, në shkallë të gjerë e të organizuar në qeverisjen e vendit dhe të ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë mbi këdo e mbi gjithçka.

Pushteti në RPSSH është një dhe i pandarë. Organet shtetërore përfaqësuese, Kuvendi Popullor e këshillat popullore, të zgjedhura drejtpërdrejt nga populli me votim të përgjithshëm, të barabartë e të fshehtë, sipas Kushtetutës, janë të vetmet që ushtrojnë sovranitetin e popullit. Të gjitha organet e tjera shtetërore zhvillojnë veprimtarinë e vet nën drejtimin dhe nën kontrollin e organeve përfaqësuese dhe japin llogari para këtyre. Ndërkaq, gjithë të zgjedhurit, por edhe nëpunësit e emëruar të shtetit janë të detyruar të japin llogari sistematikisht para popullit.

Kongresi vuri në dukje se «ndërtimi dhe funksionimi i tërë mekanizmit shtetëror e shoqëror socialist te ne kryhet sipas parimit të centralizmit demokratik, thelbin e të cilit e përbën udhëheqja e centralizuar e tërë jetës së vendit nga klasa punëtore, nëpërmjet Partisë së saj dhe shtetit proletar, kombinimi i drejtimit të centralizuar me iniciativën krijuese të organeve lokale dhe të masave punonjëse»². Duke mishëruar këtë parim revolucionar, Kushtetuta e RPSSH u kundërvihet gjithë koncepteve e praktikave revizioniste, si liberalo-anarkiste që mohojnë

1 Enver Hoxha. Raport në Kongresin VII të PPSH. Kongresi VII i PPSH, 1977, f. 34.

2 Po aty, f. 35.

centralizmin proletar, ashtu edhe centralisto-burokratike që përjashtojnë masat punonjëse nga pjesëmarrja në qeverisje.

Ndryshe nga vendet kapitaliste e revizioniste, ku të drejtat e njeriut punonjës ngelen në letër e në fjalë, në RPSSH, këto të drejta të mishëruara në Kushtetutë, siç janë barazia e të gjithë shtetasve përpara ligjit, pavarësisht nga seksi, raca, kombësia, arsimi, pozita shoqërore; e drejta e punës, liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e manifestimit publik; arsimi dhe shërbimi mjekësor falas; barazia midis gruas e burrit etj. realizohen efektivisht dhe plotësisht. Kushtetuta u siguron pakicave kombëtare mbrojtjen e zhvillimin e kulturës dhe të traditave popullore, përdorimin e gjuhës amtare, zhvillimin shoqëror të barabartë.

Të drejtat shkojnë në unitet dhe në harmoni me detyrat, zbatimin e të cilave nuk bazohet vetëm në detyrimin që rrjedh nga ligjet shtetërore, por edhe në ndërgjegjen socialiste, në parimin e vënies së interesit të përgjithshëm mbi interesin vetjak.

Duke e cilësuar pronën socialiste bazë të paprekshme të rendit socialist, burimin e mirëqenies së popullit e të fuqisë mbrojtëse të atdheut, Kushtetuta e lidh organikisht pronën shoqërore me parimin socialist të shpërndarjes «nga secili sipas aftësive, secilit sipas punës». Ky parim konkretizohet me dispozita të atilla që sigurojnë një zbatim më të drejtë revolucionar të tij dhe nuk lënë vend për spekulim as nga e djathta as nga e «majta» e për krijimin e shtresave të privileguara. U sanksionua në Kushtetutë edhe vendimi i marrë prej kohësh nga Partia për mospagimin e asnjë lloji tatimi e takse nga ana e shtetasve.

Në Kushtetutë ka gjetur shprehje të plotë dhe një formulim të qartë vija e Partisë lidhur me çështjet e mëdha të mbrojtjes së atdheut, të lirisë, të pavarësisë e të sovranitetit kombëtar. Mbrojtja e atdheut, si detyra më e lartë, sigurohet nga populli i armatosur, forca kryesore goditëse e të cilit është Ushtria Popullore. Forcat e Armatosura udhëhiqen nga PPSH, kurse Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të saj është Komandant i Përgjithshëm i tyre dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes. Kushtetuta nuk i lejon askujt të nënshkruajë ose të pranojë në emër të RPSSH kapitullimin ose pushtimin e vendit, duke e cilësuar çdo akt të këtij lloji tradhti ndaj atdheut. Gjithashtu ajo nuk lejon vendosjen e bazave

dhe të forcave të huaja ushtarake në territorin e shtetit shqiptar. Duke marrë parasysh se pavarësi të vërtetë politike s'mund të ketë pa pavarësi ekonomike, ligji i ri themelor ndalon në të njëjtën mënyrë dhënien e koncesioneve, krijimin e shoqërive dhe institucioneve të tjera ekonomike e financiare të huaja ose të përbashkëta me monopolet e me shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, si edhe marrjen e kredive prej tyre.

Ruajtja e pavarësisë ekonomike e politike, nënvizoi Kongresi, janë drejtpërdrejt të kushtëzuara nga zbatimi konsequent i parimit të mbështetjes në forcat e veta. Kushtetuta e ligjësoi edhe këtë parim të madh revolucionar që kanë ndjekur kurdoherë Partia dhe populli shqiptar në revolucion, në ndërtimin socialist dhe në mbrojtjen e vendit.

Kushtetuta sanksionoi edhe një varg parimesh, normash e fitoresh që qëndrojnë në themelet e shoqërisë socialiste në Shqipëri.

«Kushtetuta e re — tha shoku Enver Hoxha, — jep pasqyrën e një shoqërie të vërtetë socialiste, që ndërtohet sipas mësimeve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, të mishëruara dhe të vërtetuara në praktikën revolucionare të vendit tonë»¹.

Ky dokument themeltar shërbeu për forcimin dhe përsosjen e mëtejshme e të gjithanshme të shtetit socialist shqiptar, i dha një shtytje të re të fuqishme luftës dhe punës revolucionare për plotësimin e detyrave të mëdha të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Kushtetuta e re e RPSSH hyri në veprim më 28 dhjetor 1976, pas miratimit të saj të njëzëshëm nga Kuvendi Popullor.

Udhëheqja e pandarë e Partisë — garanci për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste — Detyrat e mëdha që qëndronin përpara vendit shtronin nevojën e forcimit të mëtejshëm të Partisë, të ngritjes në një nivel më të lartë të rolit të saj udhëheqës.

Për arritjen e këtij qëllimi, Kongresi kërkoi të punohet për të kuptuar gjithnjë më mirë e më thellë se *«udhëheqja e Partisë është një dhe e pandarë. Ajo realizohet vetëm kur zbatohen*

¹ Kongresi VII i PPSH, f. 45-46.

me sukses ideologjia dhe politika marksiste-leniniste, vendimet e direktivat e saj në të gjitha fushat e në të gjitha drejtimet, në pushtet e në ekonomi, në kulturë e në ushtri, kur gjithë institucionet shtetërore, organizatat shoqërore, tërë kuadrot e punonjësit udhëhiqen në gjithë veprimtarinë e tyre nga kjo ideologji e politikë, nga këto direktiva e vendime»¹.

Një nga faktorët kryesorë që i kishte dhënë mundësi Partisë të siguronte gjatë gjithë jetës së vet rolin udhëheqës, hegjemoninë e klasës punëtore në një mënyrë aq të plotë ishte uniteti i saj i çeliktë ideologjik e organizativ.

Për të ruajtur dhe për të çelikusur vazhdimisht unitetin, për të realizuar udhëheqjen e padiskutueshme të klasës punëtore, rëndësi vendimtare, theksoi Kongresi, ka gjithnjë të luftohet me këmbëngulje, për të mos lejuar kurrë ekzistencën e fraksioneve e të vijave të kundërta në gjirin e saj, për të zbatuar me vendosmëri një vijë të vetme marksiste-leniniste konsekuente të Partisë, një disiplinë të vetme revolucionare për gjithë komunistët pavarësisht nga pozita e funksioni.

Që të realizohet plotësisht roli udhëheqës i Partisë, Kongresi nënvizonte edhe një kusht tjetër të domosdoshëm, që e kishte vërtetuar praktika e deriatëhershme: çdo organ i Partisë, i çdo shkalle, çdo organizatë-bazë të jetë në rolin udhëheqës, e tërë masa e komunistëve të jetë në pararojë.

Organizata-bazë është themeli i Partisë. Sa më i çeliktë të jetë ky themel, aq më e fortë, aq më e çeliktë është Partia. Partia e ka ngritur dhe e ngrinte përsëri forcimin e rolit udhëheqës të organizatës-bazë, sepse nga kjo çështje, më shumë se nga çdo çështje tjetër, varet kryerja e misionit të saj historik të udhëheqjes proletare në revolucion e në ndërtimin socialist. Shoku Enver Hoxha mëson se «organizata-bazë duhet të jetë kudo në udhëheqje, që të jemi në rregull me parimin «Partia të udhëheqë çdo gjë»»².

Njëkohësisht u dha orientim të tregohet kujdes i vazhdueshëm për të forcuar e për të përsosur rolin udhëheqës të plenumeve të komiteteve të Partisë të rretheve e të komiteteve të Partisë në ushtri. «Plenumi është forumi më i lartë, midis dy konferencave, që udhëheq gjithë punët e partisë në rreth,

1 Kongresi VII i PPSH, f. 104.

2 Enver Hoxha. Fjala në Byronë Politike, 5 mars 1975. AQP.

— theksonte Kongresi. — Byroja nuk mund të zëvendësojë kurrë plenumin dhe nuk mund të kryejë në asnjë mënyrë detyrat e veta jashtë vendimeve të tij, jashtë kontrollit të anëtarëve të plenumit. Ajo është e detyruar të japë llogari për veprimtarinë e saj përpara plenumit. Nga këto parime nuk përjashtohen as Komiteti Qendror e Byroja e tij Politike»¹.

Për ngritjen e rolit të plenumeve si forume udhëheqëse që fituar një përvojë e madhe, veçanërisht në vitet e fundit. Mbi bazën e mësimeve që kishte nxjerrë Partia nga kjo përvojë, do të vazhdohej lufta për të arritur plotësisht zhvendosjen e qendrës së gravitetit të udhëheqjes nga byrotë te plenumet, duke zhdukur çdo shfaqje të kultit të byrove e të sekretarëve, të vënies së byrove mbi plenumet, të veshjes së aparateve me funksione që u takojnë komiteteve të partisë.

Thelbi i kësaj lufte është sigurimi sa më i plotë i kolegjalitetit në punën e organeve udhëheqëse të partisë. «Mendimi dhe veprimi kolegjal, — theksoi Kongresi, — është mendimi dhe veprimi më i thellë e më i drejtë, që ka rolin vendimtar në realizimin e udhëheqjes së Partisë. Kolegjaliteti mënjanon burokracinë e arbitraritetin, gjallëron në të njëjtën kohë edhe mendimin e veprimin individual, nuk lë të krijohet rutinë dhe të përhapet konformizmi»².

Një çështje tjetër e madhe për ngritjen në një shkallë më të lartë të rolit udhëheqës të Partisë është forcimi i pareshtur i përbërjes proletare të Partisë.

Që nga kongresi i mëparshëm ishin shënuar në këtë çështje përparime të tjera të dukshme. Ndër komunistët e rinj të pranuar brenda kësaj periudhe, 41 për qind vinin nga punëtorët, 38 për qind nga kooperativistët, 21 për qind nga nëpunësit, inteligjencia dhe ushtarakët. 82 për qind të pranimeve i kishin kryer organizatat e sferës së prodhimit material.

Shumica dërrmuese e të pranuarve ishin të moshës deri në 30 vjeç. Kjo dëshmonte, vërente Kongresi, për lidhjet e çeliktatë të rinisë me Partinë e me komunizmin, për kujdesin e vazhdueshëm që tregonte Partia për të mos u plakur kurrë fizikisht, për të qëndruar gjithnjë e pjekur dhe e re njëkohësisht

1 Kongresi VII i PPSH, f. 113-114.

2 Po aty, f. 114-115.

nga mendimi e nga veprimi revolucionar, parti e së tashmes dhe e së ardhmes.

Në efektivin e përgjithshëm të Partisë komunistët punëtorë mbanin gjithnjë vendin e parë me 37,5 për qind. Komunistët kooperativistë zinin 29 për qind. Një shtesë e rëndësishme qe bërë në numrin e grave komuniste, të cilat kishin arritur 27 për qind të efektivit, kundrejt 22 për qind pesë vjet përpara.

Përparimet e arritura në përbërjen shoqërore të Partisë do të shërbenin për t'i zhvilluar ato më tej në rrugë revolucionare.

Do të vazhdonin përpjekjet për ta shtuar Partinë me anëtarë të rinj, të dalë nga klasa punëtore në radhë të parë dhe nga fshatarësia kooperativiste. Kongresi vuri si pikësynim që komunistët kooperativistë në perspektivë të dalin në vendin e dytë, pas punëtorëve.

Në pesëvjeçarin e kaluar, më shumë se në çdo periudhë tjetër, qenë dërguar komunistë nga administrata në prodhim, nga qyteti në fshat, nga frontet më pak të vështira në frontet më të vështira. 62 për qind e efektivit të përgjithshëm të komunistëve punonin në sferën e prodhimit, 82 për qind e këtyre drejtpërdrejt në prodhim. Në minierat e në gjeologji ata zinin më se 86 për qind, në kooperativat bujqësore 87 për qind.

U kërkua që në të ardhmen të përsoset më tej raporti i komunistëve me punë drejtpërdrejt në prodhim në sektorët ekonomikë kundrejt komunistëve me punë në administratë, në dobi të të parëve.

Ngritja më lart e rolit udhëheqës të Partisë, ruajtja dhe forcimi i vazhdueshëm i lidhjeve të saj me masat, çelikosja e mëtejshme e unitetit Parti-popull, arrihen gjithnjë mbi bazën e bindjes së masave në drejtësinë e vijës së Partisë. Kongresi sillte për të argumentuar këtë të vërtetë, thënien e Stalinit, i cili nënvizonte se «të udhëheqësh do të thotë të bindësh masat në drejtësinë e politikës së Partisë»¹. Çdo përpjekje për t'iu imponuar masave me forcën e urdhrit, me zbatimin mekanik të parimit të rolit udhëheqës të partisë së klasës punëtore, shkel vijën e Partisë, largohet nga vija e masave. Bindja arrihet në radhë të parë me anë të veprës që është në unitet me

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 8, f. 52.

fjalën, me anë të shembullit, që japin komunistët si luftëtarë pararojë.

Për të krijuar bindje të thella te masat në vendimet e direktivat e Partisë, në detyrat konkrete që burojnë nga këto vendime e direktiva një rol të madh e të pazëvendësueshëm luajnë organizatat shoqërore, si shkolla edukimi komunist e pjesëmarrjeje të masave në qeverisje, si leva për zbatimin e vijës së Partisë. Lidhur me këtë Kongresi kërkoi të përsoset drejtimi i organizatave shoqërore nga organizatat dhe organet e Partisë. Përvoja e pasur e PPSH në punën me këto organizata ka treguar se udhëheqja e vazhdueshme, e urtë proletare e saj mbi organizatat e masave nuk lejon të krijohet një gjendje amullie në veprimtarinë e tyre, as të lindin pikëpamje e praktika antimarksiste, revizioniste të shkëputjes nga Partia, të daljes së tyre mbi Partinë e mbi klasën punëtore, të vet-administrimit e të ekonomizmit, të mohimit të diktaturës së proletarietit, përkundrazi i mban ato kurdoherë armë të mprehta të Partisë e të pushtetit proletar.

Lufta e klasave, forcë kryesore lëvizëse që çon përpara revolucionin dhe ndërtimin e socializmit

Kongresi u ndal në mënyrë të veçantë në çështjen e luftës së klasave, duke formuluar përmbledhtas vijën e Partisë për këtë çështje në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit dhe të përvojës së saj revolucionare shumëvjeçare.

PPSH ka pasur gjithnjë një vijë të qartë, të prerë, revolucionare për luftën e klasave, kurdoherë e ka zhvilluar dhe e ka udhëhequr drejt e me vendosmëri këtë luftë. Kongresi e gjykoi të domosdoshme të qëndronte në mënyrë të posaçme në këtë çështje për arsye se lufta e klasave në situatat e reja merrte një rëndësi edhe më vendimtare për fatet e socializmit e të pavarësisë kombëtare. Sa më mirë e më thellë të kuptohet e të përvetësohet dhe sa më drejt të zbatohet vija e Partisë për luftën e klasave, aq më mirë e më e plotë zbatohet vija e përgjithshme marksiste-leniniste e saj për të ecur gjithnjë përpara në rrugën e zhvillimit socialist.

PPSH ka pasur gjithnjë një vijë të qartë, të prerë, revolucionare për luftën e klasave, kurdoherë e ka zhvilluar dhe e ka udhëhequr drejt e me vendosmëri këtë luftë. Kongresi e gjykoi të domosdoshme të qëndronte në mënyrë të posaçme në këtë çështje për arsye se lufta e klasave në situatat e reja merrte një rëndësi edhe më vendimtare për fatet e socializmit e të pavarësisë kombëtare. Sa më mirë e më thellë të kuptohet e të përvetësohet dhe sa më drejt të zbatohet vija e Partisë për luftën e klasave, aq më mirë e më e plotë zbatohet vija e përgjithshme marksiste-leniniste e saj për të ecur gjithnjë përpara në rrugën e zhvillimit socialist.

Kongresi e ritheksoi tezën e njohur të Partisë, sipas së cilës lufta e klasave «edhe në socializëm është një fenomen

është fenomeni

objektiv, është forcë kryesore lëvizëse, që çon përpara revolucionin dhe ndërtimin e socializmit»¹.

Kjo tezë përputhet me përcaktimin që i kanë bërë klasikët e marksizëm-leninizmit luftës së klasave si «forcë që përcakton zhvillimin e shoqërisë», «forcën e vërtetë lëvizëse të historisë», që vazhdon deri në zhdukjen e klasave.

«Ndërtimi i socializmit është proces i një lufte të ashpër klasore...»². Kjo do të thotë se fenomen objektiv nuk është vetëm ekzistenca e luftës së klasave, por edhe ashpërsia e saj. Objektivisht armiku i klasës bën vazhdimisht rezistencë, pression, nuk heq dorë vullnetarisht nga pushteti, nga pasuritë, nga privilegjet e tij. Ai lufton me ashpërsi kundër forcave politiko-shoqërore që synojnë ta shfarosin. Nga ana tjetër, klasa punëtore me aleatët e saj i arrin vetëm me revolucion dhe me luftë të vendosur objektivat e caktuara, ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste.

Zigzagjet, uljet e ngritjet që vërehen në luftën e klasave janë shkallë të ashpërsimit. Ato kanë lidhje me çështjet për të cilat bëhet konkretisht kjo luftë, me momente të veçanta të luftës, me situatat dhe me koniunkturat e brendshme e ndërkombëtare, si edhe me faktorë të tjerë të karakterit objektiv e subjektiv.

Në veprimtarinë praktike ka shumë rëndësi të kuptohet e të zbatohet drejt ky konkluzion i Partisë, i vërtetuar nga praktika për të mbajtur kurdoherë qëndrime të drejta, për të mos rënë as në oportunizëm as në sektarizëm.

Nga ana tjetër, Partisë dhe diktaturës së proletariatit nuk u lejohet as të nxitin ose ta ngrenë artificialisht luftën e klasave. PPSH kurrë nuk e ka bërë një gjë të tillë, kurrë nuk ka ndërmarë veprime të nxituara, aventureske.

Nxitja artificiale e luftës së klasave, shpjegonte Stalini, të çon në luftë civile; nderzja e një lufte të tillë në kushtet e diktaturës së proletariatit i vë kazmën socializmit.

Nëpërmjet luftës së klasave zgjidhen kontradiktat klasore, antagoniste e joantagoniste, dhe zhvillohet përpara shoqëria. PPSH e ka pasur gjithnjë të qartë se me zhdukjen e klasave shfrytëzuese në socializëm nuk zhduken kontradiktat antago-

1 Kongresi VII i PPSH, f. 140.

2 Po aty.

niste. Ato vazhdojnë të ekzistojnë krahas kontradiktave joantagoniste, që janë karakteristike për shoqërinë socialiste.

Kontradiktat antagonistë janë midis rrugës socialiste dhe rrugës kapitaliste, midis ideologjisë proletare dhe ideologjisë borgjeze e revizioniste, midis moralit socialist dhe psikologjisë mikroborgjeze, paragjykimeve fetare e zakoneve prapanike, midis popullit punonjës dhe armiqve. Kontradiktat joantagoniste gjenden midis masave punonjëse, midis anëve të ndryshme të rendit socialist.

Kontradikta themelore antagonistë deri në triumfin e komunizmit mbetet në thelb kontradikta midis socializmit e kapitalizmit.

Për ta zhvilluar drejt luftën e klasave është e domosdoshme të njihen thellë kontradiktat dhe karakteri i tyre; të përcaktohet drejt kontradikta themelore, nga zgjidhja e së cilës varet zgjidhja e gjithë kontradiktave; të mos ngatërrohen kontradiktat antagonistë me ato joantagoniste dhe anasjelltas; të mos nënvleftësohet ose të mbivlerësohet as njëra as tjetra palë e kontradiktave.

Duke përsëritur tezën e Partisë, sipas së cilës lufta e klasave zhvillohet në të gjithë fushat e frontet, Kongresi theksoi: «Praktika jonë e revolucionit dhe e ndërtimit socialist na mëson se kurrë nuk është e plotë ajo luftë klasore që nuk zhvillohet në të tëra drejtimet kryesore të saj, politike, ekonomike dhe ideologjike. . . Në periudha të caktuara mund të dalë në plan të parë herë njëra e herë tjetra formë e luftës së klasave, por në çdo rast kjo luftë duhet zhvilluar frontalisht»¹.

Njëkohësisht Kongresi vuri në dukje se lufta e klasave jo vetëm është e domosdoshme dhe njësoj e rëndësishme të zhvillohet në të gjitha fushat e drejtimet, por edhe se të tria format kryesore të kësaj lufte — politike, ekonomike, ideologjike — «gërshetohen dhe plotësojnë njëra-tjetrën»². Lufta e klasave zhvillohet kështu e ndërthurur, sepse të ndërthurura janë edhe ideologjia, politika dhe ekonomia.

Pleksja dhe rëndësia njësoj e madhe që ka lufta klasore në secilin drejtim kryesor nuk e rrëzojnë poshtë tezën se lufta politike mbetet, derisa të zhduken klasat dhe armiqtë, forma

1 Kongresi VII i PPSH, f. 148.

2 Po aty.

më e lartë e luftës së klasave, në kuptimin që për asnjë çështje tjetër kjo luftë nuk merr atë ashpërsi dhe nuk ngjitet në ato kulme si për pushtetin shtetëror. Këtu i ka rrënjët edhe lufta e ashpër që është zhvilluar gjithnjë, që do të zhvillohet edhe në të ardhmen, midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve për çështjen e diktaturës së proletarietit.

Kongresi trajtoi edhe lidhjen e ngushtë, gërshetimin midis frontit të brendshëm e të jashtëm të luftës së klasave. Kjo lidhje e ky gërshetim e kanë burimin në lidhjet e bashkëveprimin midis armiqve të jashtëm e të brendshëm. Të gjithë armiqtë e brendshëm, pa përjashtim, janë njëkohësisht, në një mënyrë ose në një tjetër, agjentë të armiqve të jashtëm imperialistë e revizionistë. Fijet që i bashkojnë të parët me të dytë janë të shumta. «Prandaj frontit të bashkuar të armiqve, — udhëzoi Kongresi, — duhet t'i bëjmë ballë duke forcuar frontin tonë të brendshëm në të gjitha drejtimet, në fushën e mbrojtjes dhe të ekonomisë, të politikës e të ideologjisë, duke zhvilluar me konsekuencë kurdoherë luftën e klasave»¹.

Lufta e klasave është një ligj objektiv, por rolin vendimtar në rezultatet e kësaj lufte e luan faktori subjektiv. Fitorja e socializmit varet nga ndërgjegjja, gatishmëria, përgatitja, organizimi, mobilizimi, zotësia në luftë e klasës punëtore dhe e masave të tjera punonjëse, kushte këto subjektive, që i përgatit partia e klasës punëtore, si udhëheqëse e revolucionit.

Nga Partia kërkohet të ndjekë një vijë revolucionare të luftës së klasave, të ndërtuar mbi bazën e njohjes së thellë e të zbatimit të ligjeve e të kushteve objektive të kësaj lufte, të zhvillojë luftën me metoda revolucionare, gjithnjë tok me masat e nën udhëheqjen e saj.

Çdo qëndrim dhe veprim jo në përshtatje me ligjet dhe kushtet objektive, qëndrimi në pritje, aventurizmi, hutimi, frika, humbja e toruas në luftë dhe aq më keq kapitullimi përpara presionit të armiqve ose vështirësive e pengesave janë vdekje për revolucionin, shkaktojnë disfatën në luftën klasore, japin mundësi të fitojnë forcat kundërshtare, borgjezo-imperialiste, revizioniste, reaksionare.

«Armiku i klasës, — vuri në dukje Kongresi, — përpiqet të vërë në gjumë vigjilencën e masave, ai kërkon periudha qetësie

1 Kongresi VII i PPSH, f. 145-146,

e pauza në zhvillimin e luftës klasore, që të mbledhë forcat e të godasë në befasi. Detyra e organizatave të partisë, e gjithë punonjësve, me klasën punëtore në krye, është që të mos lejojnë krijimin e situatave të tilla të favorshme për armikun, por të jenë kurdoherë në sulm, ta mbajnë kurdoherë të mprehtë tehun e luftës klasore, të jenë të papajtuëshëm me armiqtë dhe me ideologjitë e tyre»¹.

Shkolla të mëdha të luftës klasore ishin Plenumi i 4-t, i 5-të, i 6-të e i 7-të i KQ të Partisë. Lufta kundër grupeve tradhtarë që zbuluan e që shkatërruan këto plume tregoi edhe një herë se «*rreziku dhe armiku kryesor për Partinë tonë, ashtu si për të gjithë lëvizjen komuniste e punëtore revolucionare ndërkombëtare, ka qenë dhe mbetet oportunizmi i djathtë, revizionizmi*»².

Partisë së Punës të Shqipërisë i është dashur të zhvillojë një luftë të ashpër frontale kundër oportunizmit të djathtë.

Njëlloj ka luftuar Partia edhe kundër sektarizmit, kundër qëndrimeve të ngurta, majtiste. «Ata që tregohen sektarë, — tha shoku Enver Hoxha, — shpesh hiqen sikur janë «revolucionarë konsekuentë», «parimorë». Por në fakt janë oportunistë dhe veprojnë kështu «për të qenë brenda»». «Partisë, — vuri detyrë Kongresi, — i duhet t'i sqarojë thellë këto çështje dhe të shpjegojë se *nuk mund të luftohet me sukses oportunizmi, po nuk u luftua njëkohësisht edhe sektarizmi e anasjelltas*»³.

Faktor vendimtar në zhvillimin e luftës së klasave e në fitoren e plotë të socializmit mbi kapitalizmin dhe mbi revizionizmin është *udhëheqja e klasës punëtore*. Si të sigurohet kjo udhëheqje, si të qëndrojë e të mos asgjësohet pasi është arritur një herë, nga kjo varet gjithçka.

Përvoja e ndërtimit socialist në Shqipëri hedh poshtë konkluzionet antikomuniste që nxjerrin borgjezia me shërbëtorët e saj nga rivendosja e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik dhe vërteton plotësisht drejtësinë e teorisë marksiste-leniniste të rolit hegjemon të klasës punëtore dhe të luftës së klasave.

Për realizimin e udhëheqjes së klasës punëtore në socializëm, si një armë e fuqishme në duart e Partisë ka shërbyer kontrolli i drejtpërdrejtë punëtor.

1 Kongresi VII i PPSH, f. 149.

2 Po aty, f. 141.

3 Po aty, f. 150, 151.

Duke përdorur këtë armë, Partia ka tërhequr vëmendjen të mos ngatërrohet kontrolli i drejtpërdrejtë me udhëheqjen «e drejtpërdrejtë» të klasës punëtore.

Klasa punëtore e ushtron rolin hegjemon në revolucion me anë të partisë së vet, si edhe me anë të diktaturës së proletariatit kur ajo arrin të vendosë pushtetin proletar. Asnjë klasë gjatë historisë s'ka mundur të sundojë e të udhëheqë drejtpërdrejt, por vetëm nëpërmjet organizatave e partive politike ose shtetit të vet.

Kontrrolli i drejtpërdrejtë nuk është udhëheqje e drejtpërdrejtë. Ai realizohet nën udhëheqjen e Partisë dhe ka si pikësynim ruajtjen e forcimit e karakterit proletar të shtetit të Partisë, zbatimin plotësisht të vijës proletare të saj, të ligjeve e të planeve të shtetit socialist.

Kongresi shtronte detyrë të forcohet vazhdimisht roli udhëheqës i klasës punëtore. Për këtë, udhëzonte ai, «Partisë do t'i duhet edhe në të ardhmen të punojë me këmbëngulje për ta edukuar klasën me ideologjinë marksiste-leniniste, për ta bërë të ndërgjegjshme për rolin dhe detyrat e saj. . .»¹.

Duke i dhënë klasës punëtore rolin udhëheqës që i ka caktuar historia, PPSH ka vlerësuar kurdoherë drejt edhe vendin e forcën e madhe të fshatarësisë punonjëse. Në valën e revolucionit, në betejat e ashpra klasore, ajo ka farkëtuar një aleancë të fuqishme të klasës punëtore me fshatarësinë nën udhëheqjen e klasës punëtore. «Kjo aleancë, — theksoi Kongresi, — ka qenë dhe mbetet parimi bazë i diktaturës së proletariatit, themeli i unitetit të popullit rreth Partisë»².

Të vazhdohen ritmet e shpejta të zhvillimit socialist. Kongresit VII të Partisë i duhej medoemos të mbante parasysh gjithë faktorët, të brendshëm e të jashtëm, që ndikojnë për të mirë e për të keq, për të caktuar detyrat e planit të ri pesëvjeçar.

Thellimi i krizës ekonomike në botën kapitaliste dhe dalja hapur e revizionizmit kinez, afrimi i Kinës me imperializmin

1 Kongresi VII i PPSH, f. 165.

2 Po aty, f. 167.

amerikan dhe futja e saj në rrugën e shndërrimit në një superfuqi imperialiste kishin krijuar një situatë të re ndërkombëtare. Kjo situatë kishte nxjerrë për zhvillimin ekonomik e për mbrojtjen e Shqipërisë socialiste vështirësi e pengesa të tjera, veç atyre që kishte më parë.

Megjithatë, faktorët e brendshëm, që janë gjithnjë vendimtarë (udhëheqja revolucionare dhe vija e drejtë e Partisë, diktatura e proletarietit, uniteti i çeliktë Parti-popull, rendi ekonomik socialist, baza materialo-teknike përkatëse, armata e kuadrove dhe e specialistëve, masa e gjerë e punëtorëve dhe e bujqve të kualifikuar, shprehinë e thella prodhuese, organizuese e drejtuese të fituara në pesëvjeçarin e kaluar) jepnin të gjitha mundësitë për kapërcimin e vështirësive e pengesave dhe për vazhdimin me ritme të shpejta të zhvillimit socialist.

I nisur nga ky realitet, Kongresi shtroi këtë detyrë themelore për planin e 6-të pesëvjeçar 1976-1980: **vazhdimi me ritme të shpejta i ndërtimit socialist të vendit, për shndërrimin e Shqipërisë socialiste në një vend industrialo-bujqësor, me industri e bujqësi të përparuar, sipas parimit të mbështetjes në forcat e veta, për forcimin e mëtejshëm e të gjithanshëm të pavarësisë ekonomike të vendit; përsosja e mëtejshme e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe e superstrukturës; forcimi i diktaturës së proletarietit dhe rritja e aftësive mbrojtëse të atdheut; ngritja e mëtejshme e nivelit material e kulturor të masave punonjëse, duke çuar më tej ngushtimin e dallimeve ndërmjet qytetit e fshatit.**

Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial në pesëvjeçarin e 6-të llogaritej të ishte më i madh se vëllimi i prodhimit të realizuar gjatë 20 vjetëve të mëparshëm 1951-1970. Zhvillimin më të lartë do ta kishte industria e hekur-nikelit, industria elektrike, industria kimike. Industria do të siguronte 95 për qind të nevojave të vendit për pjesë ndërrimi.

Prodhimi bujqësor do të ishte i barabartë me prodhimin e tre planeve të para pesëvjeçare 1951-1965. Objektiv kryesor në bujqësi përcaktohej sigurimi i plotë i bukës në vend. Por bujqësia orientonte Kongresi, duhej të merrte një zhvillim të gjithanshëm e të harmonizuar, në të gjitha degët e saj.

Gjatë viteve 1976-1980 skteteti do të investonte më shumë sesa pati investuar për periudhën 20-vjeçare 1951-1970. Kongresi vinte theksin te përdorimi i investimeve me efektivitet

të lartë, mbi bazën e studimeve të plota, të projekteve e të preventivave të sakta, të normave të përparuara tekniko-ekonomike.

Të ardhurat kombëtare parashikohej të rriteshin përpjesëtimisht me rritjen e produktit të përgjithshëm shoqëror. 35 përqind e tyre do të shkonin në fondin e akumulimit. Shpenzime të rëndësishme do të bëheshin për shtimin e fondit të banesave, për mbrojtjen e shëndetit të popullit, për ruajtjen e mjedisit nga ndotja etj.

Detyra të rëndësishme vinte Kongresi për zhvillimin e arsimit, të kulturës dhe të shkencës. Ai jepte direktivë të shndërroheshin kërkimet shkencore në metodë të përgjithshme që të përshkojë e të paraprijë çdo punë, që të ndihmojë efektivisht për zgjidhjen e problemeve aktuale e të perspektivës të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut.

Në mënyrë të posaçme Kongresi përqendroi vëmendjen në çështjen e ngushtimit të dallimeve midis qytetit e fshatit, duke e përcaktuar luftën në këtë fushë si rrugën kryesore në kushtet aktuale për forcimin e mëtejshëm të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste. Në këtë çështje, tha shoku Enver Hoxha në raport, Partia udhëhiqet «nga parimi se socializmi nuk ndërtohet vetëm në qytet dhe as vetëm për klasën punëtore, por ndërtohet edhe në fshat, edhe për fshatarësinë»¹. Për zhvillimin e mëtejshëm të fshatit shteti do të vepronte më fuqimisht me mjete, me fonde e me ndihmë të gjithanshme për ngritjen në përgjithësi të nivelit të jetesës së fshatarësisë kooperativiste gjithnjë mbi bazën e rritjes së prodhimit bujqësor e blegtoral. Në planin e ri pesëvjeçar të ardhurat reale për frymë të popullsisë fshatare parashikohej të rriteshin tri herë më shpejt se në qytet.

Zbatimi me sukses i detyrave ekonomike të pesëvjeçarit të ri do të fuqizonte më tej mbrojtjen e atdheut. Njëkohësisht, për rritjen e aftësisë mbrojtëse të vendit, Kongresi vuri detyra të posaçme në fushën e stërvitjes ushtarake e të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura, të mbarë popullit ushtar. Ushtria Popullore dhe gjithë strukturat e tjera ushtarake, të udhëhequra nga ideologjia e politika proletare e

¹ Kongresi VII i PPSH, f. 89.

Partisë, ngarkoheshin të zhvillonin një punë të gjerë, këmbëngulëse, me disiplinë të çeliktë, për të përvetësuar vijën ushtarake të Partisë, artin ushtarak të luftës popullore, për të zotëruar në mënyrë të përsosur teknikën luftarake.

Në kushtet e pleksjes së rrethimit imperialisto-revizionist me krizën e madhe ekonomiko-financiare të botës kapitaliste zbatimi i parimit të mbështetjes në forcat e veta merrete një rëndësi të jashtëzakonshme. «Ky parim i madh marksist-leninist, me përmbajtje të thellë revolucionare, — theksonte Kongresi, — është jo vetëm një ligjësi e ndërtimit të socializmit, por edhe një domosdoshmëri imperative në kushtet e vendit tonë për t'u bërë ballë me sukses bllokadave e rrethimit të armiqve»¹.

Qëndrimi parimor i PPSH për problemet e zhvillimit botëror

Politika e jashtme e PPSH ka qenë kurdoherë politike e parimeve proletare,

ashtu siç ka qenë edhe politika e brendshme, vija e saj e përgjithshme. Në gjithë rrugën e saj, në çdo çast vendimtar, për çdo problem-kyç, të brendshëm e të jashtëm, PPSH ka mbajtur qëndrime parimore marksiste-leniniste. Në vitin 1960, kur një shumicë partish ish-komuniste kishin përqafuar ose po përqafonin kursin borgjezo-revizionist të Hrushovit, kur ky zhvillonte një presion të jashtëzakonshëm mbi PPSH për ta detyruar edhe atë të largohej nga rruga e marksizëm-leninizmit, shoku Enver Hoxha deklaronte duke shprehur vullnetin e gjithë komunistëve, të mbarë popullit shqiptar: «Edhe pa bukë të mbetemi ne shqiptarët, parimet nuk i shkelim, marksizëm-leninizmin nuk e tradhetojmë. Këtë ta kenë të qartë të gjithë, miq e armiq»².

Pikërisht në këtë politikë të parimeve proletare e ka gjetur forcën Partia e Punës e Shqipërisë për të kundërshtuar e për të përballuar armiq të mëdhenj e të fuqishëm, për të demaskuar e për të shkatërruar planet djallëzore të tyre.

Politika parimore e PPSH është armike e çdo politike pragmatiste, koniunkturore, është armike e diplomacisë së fshehtë të kuliseve, të shitjes në ankand të interesave të po-

1 Kongresi VII i PPSH, f. 95-96.

2 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 338.

pullit të vet e të popujve të tjerë, karakteristika këto të politikës së jashtme të vendeve kapitaliste e revizioniste.

Politika e parimeve proletare që ka ndjekur me konsekuencë PPSH u mishërua edhe në analizën që i bëri Kongresi VII i saj gjendjes së jashtme, në qëndrimet e pikëpamjet që shprehu ai për ngjarjet e mëdha dhe problemet e zhvillimit botëror.

«Partia jonë, — deklaroi Kongresi, — mendon se popujve u duhet folur hapur për situatat, pse vetëm kështu ndihmohet bashkimi i vërtetë i tyre, bashkimi i shteteve dhe i qeverive me të vërtetë antiimperialiste e përparimtare»¹.

Kongresi arriti në konkluzion se gjendja ndërkombëtare paraqitej e turbullt, e mbushur me kontradikta e ballafaqime të mëdha.

Superfuqitë imperialiste, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, të shtyra nga synimet për sundimin e botës, përgatiteshin në mënyrë të ethshme për luftë.

Gjendjen e turbullt ndërkombëtare e rëndonte edhe më tepër kriza shumë e thellë, më e madhja pas Luftës së Dytë Botërore, që kishte përfshirë gjithë vendet kapitaliste e revizioniste, jo vetëm vendet e zhvilluara po edhe më pak të zhvilluara. Kjo përbënte një krizë të gjithanshme në bazë e në superstrukturë të sistemit kapitalist e borgjezo-revizionist, një krizë ekonomike, politike, ideologjike, ushtarake, kulturore.

Kjo krizë ishte rrjedhim i thellimit dhe i acarimit të kontradiktave midis proletariatit e borgjezisë, midis socializmit e kapitalizmit, midis popujve dhe fuqive imperialiste, midis vetë këtyre fuqive.

«Krizë e tanishme, — tha shoku Enver Hoxha, — provoi përsëri se kapitalizmi, si sistem shoqëror, nuk mund të shpëtojë kurrë nga kontradiktat e plagët e tij, se ai është i paaftë që në të njëjtën kohë të sigurojë superfitimet e veta dhe të ruajë një ekuilibër të brendshëm shoqëror»².

Superfuqitë përpiqeshin t'i kapërcenin krizat duke kërkuar forma të reja bashkëpunimi në divergjenca, por edhe duke u përplasur me njëra-tjetrën.

1 Kongresi VII i PPSH, f. 218.

2 Po aty, f. 203.

«Partia jonë, — theksoi Kongresi, — mbron tezën se, si atëherë kur superfuqitë afrohen, ashtu edhe kur ato grinden, harxhet i paguajnë të tjerët. Bashkëpunimi e rivaliteti midis superfuqive paraqesin dy anët e një realiteti kontradiktor, janë shprehje kryesore e së njëjtës strategji imperialiste për grabitjen e lirisë së popujve dhe sundimin e botës»¹.

Përballë synimeve e veprimtarisë agresive, ekspansioniste e grabitqare të superfuqive, përballë shtypjes e shfrytëzimit barbar të monopoleve kapitaliste, përballë dhunës e terrorit të reaksionit e të kundërrevolucionit ndërkombëtar po shtoheshin vazhdimisht pakënaqësitë, po zienin e po piqeshin gjithnjë e më shumë qëndresa e lufta e proletariatis, e forcave revolucionare e përparimtare, e popujve. «Bota, — arriti në konkluzion Kongresi, — ndodhet në një fazë kur çështja e revolucionit dhe e çlirimit kombëtar të popujve nuk është vetëm një aspiratë e një perspektivë, por edhe një problem i shtruar për zgjidhje»².

Në rrethanat aktuale, një rëndësi të dorës së parë për forcat marksiste-leniniste, për të gjitha forcat revolucionare, për të gjithë kombet e popujt liridashës merrte vlerësimi i drejtë i gjendjes, mbajtja e qëndrimeve të drejta, klasore, kundrejt superfuqive. «Qëndrimi parimor në këtë çështje themelore, — vuri në dukje Kongresi, — përbën bazën e vetme të drejtë për përcaktimin e një strategjie e taktike konsekuente revolucionare, përbën kriterin e ndarjes dhe të vlerësimit të forcave përparimtare nga ato reaksionare»³.

Një qëndrim i tillë bëhej edhe më shumë i domosdoshëm në kushtet kur edhe udhëheqja kineze e kishte shpalosur krejt flamurin e revizionizmit e të socialimperializmit. Teoria antimarksiste e «tri botëve» dhe politika e bashkëpunimit me imperialistët amerikanë e me kapitalizmin botëror kundër gjoja të vetmit armik që kishte bota, socialimperializmit sovjetik, po e dendësonin edhe më tepër mjegullën rreth strategjisë e taktikës së forcave revolucionare botërore, po shkaktonin konfuzionin ideologjik e politik në radhët e këtyre forcave.

Prandaj Kongresi u ndal në mënyrë të veçantë në kritikën kundër pikëpamjeve e qëndrimeve antimarksiste të revizionizmit kinez, krahas kritikës kundër pikëpamjeve e qëndrimeve

1 Kongresi VII i PPSH, f. 230-231.

2 Po aty, f. 198.

3 Po aty, f. 207.

të revizionizmit sovjetik, jugosllav etj. Për arsye taktike, ai nuk e shikoi me vend të drejtohej me emër, por gjithë bota do ta merrte vesh kundër kujt drejtoheshin kritikata, sepse të gjithë i njihnin tashmë «teoritë» e veprimet kundërrevolucionare kinaze. *Teoritë të tërë e teorinë të tri botëve*

Duke pasur parasysh këto teori e veprime, rëndësi vendimtare, theksoi Kongresi, ka të kuptohet mirë se të dyja superfuqitë, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, janë sot fuqitë agresore më të mëdha e më të rrezikshme që ka njohur historia, se ato veç e veç ose të bashkuara përfaqësojnë në të njëjtën masë e në të njëjtën shkallë, armiqtë kryesorë të revolucionit e të socializmit. *pe një bën botën e socializmi*

Çdo pikëpamje që nuk i vë në një shkallë dy superfuqitë si armiq kryesorë, ose quan imperializmin amerikan më pak të rrezikshëm, për shkak se ky gjoja na qenka dobësuar, se nuk ndjekka një politikë agresioni e sulmi por mbrojtjeje, se nuk dashka luftën dhe rindarjen e botës por statukuonë; çdo qëndrim që bazohet në mbështetjen te njëra superfuqi për të luftuar tjetrën, si gjoja më të rrezikshme, të gjitha këto, deklaroi Kongresi, nuk janë marksiste-leniniste, revolucionare, por antimarksiste, shumë të dëmshme për revolucionin, për socializmin, për popujt.

Po ashtu janë antimarksiste dhe kundërrevolucionare pikëpamjet e qëndrimet që nuk vënë në një shkallë dhe nuk i konsiderojnë vegla njësoj shtypëse e shfrytëzuese NATO-n e Traktatin e Varshavës, Tregun e Përbashkët dhe KNER-in. Aq më tepër janë kundërrevolucionare përkrahja e njëres prej tyre kundër tjetrës, si edhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me imperializmin amerikan dhe me aleatët e tij kundër socialimperializmit sovjetik, me NATO-n kundër Traktatit të Varshavës, me Tregun e Përbashkët kundër KNER-it ose anasjelltas. Po ashtu nxitja e mbështetja e bashkimit imperialist të Evropës përbëjnë një qëndrim antimarksist, të ngjashëm me qëndrimin e Internacionales II.

Nuk është aspak marksiste-leniniste, deklaroi Kongresi, as ndarja e botës në «botë të parë», «botë të dytë», «botë të tretë» në «botë të paangazhuar», në «vende në zhvillim», siç nuk janë marksiste-leniniste edhe teoritë e revizionistëve sovjetikë e të revizionistëve të tjerë mbi «rrugën jokapitaliste të zhvillimit», mbi «socializmin kombëtar», mbi «shumëllojshmërinë e socializmit».

Të tilla ndarje e emërtime s'kanë karakter klasor, i mbulojnë në kontradiktat themelore midis proletariatit e borgjezisë, midis popujve dhe imperializmit, midis socializmit e kapitalizmit.

«Marksizëm-leninizmi, — theksoi shoku Enver Hoxha, — na mëson se në epokën tonë vendet ndahen sipas sistemit shoqëror që sundon në to, në vende borgjezo-kapitaliste dhe në vende socialiste»¹.

Të gjitha teoritë që bëjnë një ndarje ndryshe nga kjo mendojnë revolucionin, luftën e forcave përparimtare e liridashëse, ndihmojnë imperializmin dhe reaksionin.

Duke demaskuar dhe duke hedhur poshtë të tilla teori mashtruese reaksionare të revizionistëve kinezë e të tjerë, Kongresi gjykonte se në situatat kur çështja e revolucionit dhe e çlirimit kombëtar ishte shtruar për zgjidhje, proletariatit, forcave revolucionare, popujve u dilte detyrë të shtonin e të forconin luftën e gjithanshme kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, kundër borgjezisë reaksionare, të bashkoheshin në luftën për liri, për pavarësi e për përparim shoqëror. Për t'ia arritur këtij qëllimi më parë ishte e domosdoshme të viheshin kufijtë, të bëhej e qartë cilët janë armiqtë kryesorë të tyre, kundër kujt duhet luftuar dhe me cilin duhet bashkuar.

Partia e Punës e Shqipërisë e populli shqiptar, do të vazhdonin me vendosmëri së bashku me popujt e tjerë liridashës, me forcat revolucionare e përparimtare, me partitë marksiste-leniniste luftën kundër dy superfuqive, kundër luftës grabitqare imperialiste, kundër reaksionit ndërkombëtar. «*Vendi ynë, — deklaroi shoku Enver Hoxha, — do të gjendet në çdo moment përkrah gjithë atyre popujve, të cilëve u kërcënohet liria, pavarësia dhe u shkelet e drejta*»².

PPSH do të vazhdonte në të njëjtën kohë t'i kushtonte kujdesin e duhur zhvillimit e zgjerimit të marrëdhënieve të Shqipërisë socialiste me shtetet fqinje e vendet e tjera mbi bazën e parimeve të njohura të barazisë, të sovranitetit e të tërësisë tokësore, të mosndërhyrjes në punët e brendshme e të leverdisë reciproke.

PPSH shprehu në Kongres edhe një herë qëndrimin e vet të pandryshuar të kundërshtimit për të vendosur çfarëdo

1 Kongresi VII i PPSH, f. 215-216.

2 Po aty, f. 240.

marrëdhënie me SHBA dhe Bashkimin Sovjetik, si armiqtë kryesorë të popullit shqiptar e të popujve të tjerë të revolucionit e të socializmit.

Në gjendjen e re ndërkombëtare, vërente Kongresi, bëhej edhe më e domosdoshme, më imperative lufta kundër revizionizmit modern, si një luftë shpëtimtare për revolucionin, për socializmin.

PPSH këtë luftë duhet ta forcojë e ta përsosë për t'i dhënë asaj një forcë sa më bindëse, duke demaskuar jo vetëm revizionizmin në përgjithësi, si një ideologji kundërrevolucionare, por edhe çdo rrymë të tij në veçanti.

Ajo do të vazhdojë të demaskojë rrënjësisht revizionizmin sovjetik, të cilin Kongresi e cilësoi si teorinë e praktikën më të plotë të kundërrevolucionit revizionist.

Nuk do të lërë pas dore luftën kundër revizionizmit jugosllav, që shërben si një armë e preferuar e borgjezisë ndërkombëtare kundër socializmit e lëvizjeve çlirimtare.

Kongresi vinte detyrë të demaskohet edhe i ashtuquajturit «eurokomunizëm», që përfaqësohej nga partitë revizioniste italiane, spanjolle, franceze, të cilat paraqiteshin me ngjyrën e njëfarë pavarësie nga Moska, gjoja për të mashtruar borgjezinë, por në të vërtetë për të mashtruar proletariatin e popujt.

PPSH do të luftojë njësoj edhe rrymën e re revizioniste që përfaqësonte teoria e «tri botëve», e cila i sjell një shërbim të madh imperializmit e borgjezisë ndërkombëtare, si rrymat e tjera të revizionizmit modern.

PPSH do të luftojë të gjitha rrymat e teoritë e tjera antimarksiste, revizioniste e «majtiste», aq të shumta, që kanë lindur në botën e plakur kapitaliste, në çastet më kritike që po kalon kjo botë, me qëllim që t'ia zgjatin asaj jetën.

Flamurin e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar që e kishin shkelur me këmbë revizionistët, në kushtet aktuale, theksonte Kongresi, është e domosdoshme më tepër se kurrë ta ngrenë lart gjithkund partitë e vërteta marksiste-leniniste.

Gjendja aktuale në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, nxori konkluzion Kongresi, u përgjigjet periudhave historike të luftës parimore revolucionare të Marksit e të Engelsit, të Leninit e të Stalinit. Ata nuk jetojnë më, por jeton doktrina e tyre ngadhënjimtare, marksizëm-leninizmi. «Proletariati në këtë luftë të madhe e të vështirë, duhet të veprojë me radhë të

De 100 shtete kemi mon.

shtrënguara, por uniteti i radhëve të tij arrihet vetëm duke ndjekur dhe zbatuar me besnikëri doktrinën marksiste-leniniste. Partia jonë ka ecur dhe do të ecë në këtë rrugë. Ajo mbi kokë nuk ka vënë as do të vërë tjetër veç marksizëm-leninizmit»¹.

Kongresi shprehu solidaritetin e plotë internacionalist me partitë e reja marksiste-leniniste të botës, të cilat po zhvilloheshin e fuqizoheshin vazhdimisht përmes luftës revolucionare. «Ashtu siç na kanë ndihmuar në të kaluarën partitë marksiste-leniniste dhe njerëzit përparimtarë kudo në botë për çlirimin tonë nacional dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit, — u shpreh shoku Enver Hoxha në emër të të gjithë komunistëve shqiptarë, — edhe ne e kemi për detyrë të ndihmojmë proletariafin, partitë marksiste-leniniste dhe gjithë forcat përparimtare, në luftën që bëjnë, që edhe popujt e tyre të fitojnë lirinë dhe socializmin»².

Kongresi e quajti të domosdoshme që partitë marksiste-leniniste të forcojnë bashkëpunimin midis tyre, natyrisht pa genë të varura dhe pa marrë urdhër nga njëra ose nga tjetra.

Ky bashkëpunim, i ndërtuar mbi baza marksiste-leniniste mund të jetë i shumanshëm. Ai do të shërbejë për të shkëmbyer në radhë të parë përvojën midis partive. Shkëmbimi i përvojës mund të bëhet në formë dypalëshe ose shumëpalëshe. Kur të gjykohet se janë pjekur kushtet e nevojshme, mund të organizohet edhe një mbledhje e madhe e përfaqësuesve të të gjitha partive marksiste-leniniste.

Është pikërisht një politikë e tillë e parimeve proletare, e jashtme dhe e brendshme, që kishte bërë, siç vërejtë Kongresi, të rritej shumë prestigji dhe autoriteti i PPSH në lëvizjen marksiste-leniniste ndërkombëtare, të forcoheshin pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë socialiste. Ajo kishte një numër shumë të madh miqsh e dashamirësish në të gjitha kontinentet që e donin dhe e nderonin për politikën parimore e për luftën e saj konsekuente revolucionare. Vetë Kongresi VII i PPSH ishte një dëshmi e prestigjit dhe e autoritetit të saj në shkallë ndërkombëtare. Delegacionet e partive marksiste-leniniste që morën pjesë në Kongres e cilësuan raportin e shokut Enver Hoxha jo vetëm një program të madh lufte për Shqi-

1 Kongresi VII i PPSH, f. 296.

2 Po aty, f. 299.

përinë socialiste, por edhe një dokument të rëndësishëm për lëvizjen komuniste e punëtore, marksiste-leniniste, ndërkombëtare.

Në fund të punimeve Kongresi zgjodhi me vota të njëzëshme Komitetin Qendror të Partisë prej 77 anëtarësh dhe 38 kandidatësh, si edhe Komisionin Qendror të Kontrollit e të Revizionimit.

Në Byronë Politike të KQ u zgjodhën Enver Hoxha, Adil Çarçani, Haki Toska, Hekuran Isai, Hysni Kapo, Manush Myftiu, Pali Miska, Ramiz Alia, Rita Marko e Spiro Koleka.

Sekretar i Parë i KQ u rizgjodh Enver Hoxha.

Kryetar i Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit u zgjodh Pilo Peristeri.

Në punimet e Kongresit u pasqyruan tiparet revolucionare komuniste që e dallojnë Partinë e Punës të Shqipërisë nga partitë revizioniste dhe çdo parti tjetër e rreme e klasës punëtore, siç janë uniteti i çeliktë ideologjik e organizativ i saj, besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, vendosmëria, pjekuria dhe guximi revolucionar për ta zbatuar dhe për ta mbrojtur atë nga çdo shtrembërim e çdo goditje, nga çdo anë që të vijë, për të kapërcyer vështirësitë e pengesat në udhën e revolucionit dhe për të ecur pa u ndalur përpara drejt komunizmit.

Kongresi VII i Partisë hyri në histori si kongresi i Kush-tetutës së re të shtetit shqiptar në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste dhe si kongresi që filloi hapur luftën kundër revizionizmit kinez.

2. GATISHMËRIA E PARTISË DHE E POPULLIT PËR TË KRYER DETYRAT E NDËRTIMIT SOCIALIST NË ÇDO SITUATË. SHKATËRRIMI I PIKËSYNIMEVE TË REVIZIONISTËVE KINEZË

Rëndësi të dorës së parë për plotësimin e vendimeve e të detyrave që shtroi Kongresi VII i Partisë kishte që njerëzit të bëheshin plotësisht të ndërgjegjshëm për situatat në të cilat do të punonin e do të luftonin, për vështirësitë e pengesat e shumta që do të duhej të kapërcenin.

Përgatitja e gjithanshme për kryerjen e detyrave në situatën e re

Siç parashikonte Kongresi, imperialistët e revizionistët i dendësuan presionet ideologjike, politike dhe ekonomike mbi Shqipërinë që të pengonin ecjen e saj përpara në rrugën e socializmit. Veçanërisht u shtua veprimtaria armiqësore anti-shqiptare e udhëheqjes kineze në shenjë hakmarrjeje kundër PPSH, e cila në Kongresin e saj VII zhvilloi kritikën parimore kundër teorisë antimarksiste të «tri botëve».

Udhëheqësit kinezë akuzuan PPSH, sikur në Kongres ajo gjoja kishte sulmuar Kinën, Partinë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunin. Ata u përpoqën të ngrinin kundër saj jo vetëm popullin kinez, por edhe partitë marksiste-leniniste, gjithë forcat revolucionare botërore.

Me anë të një vargu qëndrimesh dhe veprimesh protokollare e propagandistike, udhëheqësit kinezë i jepnin opinionit botëror të kuptonte se Kina nuk e quante më Shqipërinë socialiste aleate e nuk e mbështeste. Në mënyrë demonstrative ata i zgjeruan dhe i forcuan marrëdhëniet (shtetërore e partie) me Jugosllavinë, duke mos e fshehur qëllimin e posaçëm anti-shqiptar, që kishte, midis të tjerave, ky veprim. Ftuan e pritën me nderime e bujë të jashtëzakonshme revizionistin Tito në Kinë, duke e cilësuar atë «një udhëheqës të madh marksist-leninist», kurse partinë revizioniste jugosllave «një parti marksiste-leniniste», e cila, ndërmjet shumë veprave të mëdha revolucionare(!), paskësh zgjidhur në mënyrë shembullore çështjen kombëtare, në një kohë kur është botërisht e njohur politika shoviniste e revizionistëve jugosllavë, veçanërisht ndaj shqiptarëve në Jugosllavi dhe ndaj Shqipërisë.

Ndërkaq, Komiteti Qendror i Partisë sqaroi gjithë komunistët e, nëpërmjet tyre, popullin se udhëheqja kineze ndiqte politikën e zhvillimit kapitalist të Kinës e të shndërrimit të saj në superfuqi imperialiste, se një rrymë e re revizioniste kishte dalë hapur në arenën ndërkombëtare. PPSH, si mbrojtëse e vendosur konsekuente e marksizëm-leninizmit, do të zhvillonte një luftë ideologjike pa kompromis kundër revizionizmit kinez, njësoj si kundër revizionizmit sovjetik dhe rrymave të tjera të revizionizmit modern.

Çështjen e luftës kundër revizionizmit kinez e mori në shqyrtim Plenumi i 2-të i KQ të PPSH në qershor 1977. Në bazë të direktivës së Kongresit VII, Plenumi dha orientim të

zhvillohej më tej kritika kundër teorisë reaksionare «të tri botëve», që përbënte thelbin e pikëpamjeve revizioniste e të politikës kundërrevolucionare dhe hegjemoniste të udhëheqësve kinezë. Një demaskim dërrmues, të argumentuar shkencërisht, i bënte kësaj teorie artikulli i «Zërit të popullit» i 7 korrikut 1977 «Teoria dhe praktika e revolucionit», që pati një jehonë të gjerë në shkallë ndërkombëtare.

Plenumi i KQ, duke shprehur vendosmërinë për të vazhduar luftën kundër revizionizmit kinez, paralajmëroi Partinë e popullin se udhëheqësit kinezë do të kundërvepronin jo në lëmin ideologjik, sepse këtu e ndienin veten të pazotët të luftonin kundër PPSH, por në fushat e tjera, në marrëdhëniet shtetërore, sidomos në lëmin ekonomik e ushtarak, ku ata kujtonin se do të dëmtonin socializmin në Shqipëri. Për këtë qëllim, do të shtonin gradualisht veprimet e sabotimit të ekonomisë e të mbrojtjes së RPSSH. Nuk do të zbatonin kontratat e marrëveshjet ekonomike dhe ushtarake derisa t'i prisnin krevet kreditë e ndihmat që parashikonin këto marrëveshje.

Kështu edhe ndodhi në të vërtetë. Menjëherë pas Kongresit të VII të Partisë, shumë mallra, makineri e pajisje, që duhej të dërgoheshin nga Kina në bazë të marrëveshjeve, nuk erdhën ose erdhën me defekte. Ndërkohë, specialistët kinezë që punonin në Shqipëri ndërmorën, sipas udhëzimeve nga lart, veprime të ndryshme sabotimi.

Kjo veprimtari armiqësore antishqiptare, që i shtohet veprimtarisë së gjithë imperializmit e revizionizmit ndërkombëtar, u nxori e do t'u nxirrte edhe më shumë Partisë e popullit shqiptar vështirësi të reja të mëdha.

Për t'i dalë përpara situatës së re që po krijohej, Komiteti Qendror i Partisë mori të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e komunistëve e të mbarë popullit, nga çdo pikëpamje, për të forcuar besimin në forcat e veta e për të qenë në gjendje të kryenin në çdo situatë detyrat e ndërtimit socialist e të mbrojtjes. Këtij qëllimi i shërbyen edhe Plenumi i 3-të (që u mbajt në nëntor 1977) dhe Plenumi i 4-t i KQ (që u mbajt në janar 1978).

Udhëheqja e Partisë theksonte se vështirësitë e pengesat që po krijonte veprimtaria antishqiptare e revizionistëve kinezë, e ndërthurur me veprimtarinë e armiqve të tjerë të jash-tëm, do të kapërceheshin duke mobilizuar gjithë energjitë revolucionare e patriotike të popullit, duke u mbështetur në for-

cën vigane të socializmit, në arritjet e mëdha në lëmin ekonomik e në fushat e tjera. «Asnjëherë, jo më sot, fati i socializmit dhe i Shqipërisë nuk është varur nga të tjerët, — vinte në dukje Plenumi i KQ. — Në bazë të vijës së drejtë të Partisë, ne kemi një ekonomi të fortë, të zhvilluar në mënyrë të gjithanshme e të aftë që të ecë me këmbët e veta»¹. Shqipëria socialiste, siguronte ai, me forcat e veta, është e zonja të ecë përpara duke vazhduar ritmet e shpejta të zhvillimit socialist, pa ulur nivelin e jetesës së popullit, duke pasur njëkohësisht edhe një mbrojtje të fuqishme. Ajo do të gjente forca për të çarë bllokadën imperialisto-revizioniste, e cila bëhej tani më e egër, më kërcënuese. Bllokada, e mësonte Partia popullin, çahet me punë revolucionare, me mobilizim të jashtëzakonshëm, me një disiplinë të çeliktë, me plotësimin e të gjitha detyrave.

Në situatën e re rëndësi shumë të madhe merrte plotësimi i detyrave ekonomike. Partia kërkonte që çdo punonjës, para së gjithash çdo komunist, të bëhej plotësisht i ndërgjegjshëm se përmbushja e këtyre detyrave do të thotë të ruhet e të zhvillohet më tej socializmi, të mbrohet pavarësia kombëtare.

Duke luftuar për zgjidhjen e problemeve dhe për kryerjen e detyrave aktuale, Partia ngulte këmbë që organet dhe organizatat e saj, gjithë institucionet shtetërore, shoqërore, ekonomike, ushtarake të punonin me largpamje. «Kurrë nuk duhet të ecet kuturu, qorrazi. . . pa përcaktuar objektiva të qartë për sot dhe për të ardhmen»².

Vendimtare në atë situatë ishte rritja e rolit udhëheqës të Partisë, përsosja e punës së saj drejtuese, organizuese dhe edukuese, përmirësimi i metodës dhe i stilit të kësaj pune, që ajo të fitonte një forcë sa më të madhe bindëse, mobilizuese e shndërruese.

Në mënyrë të posaçme, puna e Partisë fiton një forcë të tillë duke mënjanuar shfaqjet e njëanshmërisë, që mund të duken sidomos në rastet e ndryshimit të situatave. Komiteti Qendror i Partisë porositi organet e partisë, komunistët, kuadrot të ruheshin nga njëanshmëria. Duke vënë theksin te de-

1 Raport i Byrosë Politike në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH, 16 nëntor 1977. AQP.

2 Enver Hoxha. Fjala në Gjirokastër, mars 1978. «Kur e sotmja qëndron mbi themele të çeliktë, e ardhmja është e siguruar», f. 44.

tyrat ekonomike, nuk duhej të liheshin mënjanë detyrat në lëmin politik, ideologjik, kulturor etj. Duke filluar hapur luftën kundër revizionizmit kinez, nuk duhej të dobësohej lufta kundër revizionizmit sovjetik e rrymave të tjera të revizionizmit modern. Duke luftuar shfaqjet e liberalizmit, nuk duhej zbehur vëmendja nga lufta kundër sektarizmit e burokratizmit etj. Në momente të caktuara, në përputhje me situatat e reja, me problemet e mprehta, Partia gjithnjë ka vënë theksin herë në një çështje, herë në një tjetër, por kurrë s'ka rënë në njëanshmëri, s'ka harruar se duhen zgjidhur të gjitha problemet, se duhen kryer të gjitha detyrat, se duhet luftuar gjithnjë në dy krahët. Në shoqërinë socialiste ekziston një logjikë e hekurt e lidhjes organike midis të gjitha anëve të kësaj shoqërie, midis detyrave në fushat e ndryshme, midis të veçantës e të përgjithshmes, midis të brendshmes e të jashtmes, të detyrave e të drejtave, të demokracisë e të centralizmit, të së kaluarës, së tashmes e së ardhmes etj. Njëanshmëria është e huaj për dialektikën marksiste-leniniste, rrjedhimisht, për vijën dhe veprimtarinë revolucionare të Partisë. Edhe në situatën konkrete vetëm lufta frontale në të gjitha drejtimet, vetëm zbatimi i të gjitha detyrave, vetëm plotësimi i planeve në të gjithë sektorët e në të gjithë treguesit do të siguronte kapërcimin e vështirësive dhe mbarëvajtjen e punëve.

Demaskimi i aktit armiqësor të udhëheqjes kineze për t'i prerë kreditë Shqipërisë socialiste

rrik 1978, vendimin e saj për t'i prerë menjëherë Shqipërisë kreditë e ndihmat ekonomike dhe ushtarake e për të tërhequr që këtej gjithë specialistët.

Nota kineze, me anën e së cilës njoftohej ky vendim, përmbante plot gënjeshtra. Veç kësaj, e fshihte shkakun e vërtetë që i kishte shtyrë udhëheqësit kinezë të ndërmerrnin atë veprim arbitrar, të pabesë, armiqësor.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria e RPSSH iu përgjigjën këtij veprimi me anë të një letre që i drejtuan, më 29 korrik 1978, KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze. Letra nxirrte në shesh me argumente të shëndosha e fakte të doku-

Njësoj si dikur hrushovianët, edhe udhëheqja kineze u hodh në veprime të hapura armiqësore antishqiptare, duke shpallur më 7 ko-

mentuara gjithë gënjeshttrat dhe qëllimin e vërtetë të revizionistëve kinezë.

Veprimi kinez ishte një shkelje brutale e rregullave dhe e normave elementare në marrëdhëniet ndërkombëtare, një veprim i ndërmarrë nga pozitat e fuqisë së madhe imperialiste, që godiste socializmin në Shqipëri dhe marksizëm-leninizmin në përgjithësi.

Arsyet e vendimit për t'i prerë kreditë e ndihmat Shqipërisë nuk ishin të karakterit teknik, siç mendohej ta përligjte aktin e vet imperialist udhëheqja kineze, por të karakterit thellësisht politik dhe ideologjik. Ky akt ishte rrjedhim logjik i kursit që ndiqte ajo për zhvillimin kapitalist dhe për shndërrimin e Kinës në një superfuqi socialimperialiste.

Ky kurs kishte ndeshur në kundërshtimin e vazhdueshëm të PPSH, gjë që kishte bërë të lindnin kontradikta e mosmarrëveshje serioze ideologjike e politike midis dy partive.

PPSH, duke u nisur nga pozita revolucionare internacionaliste, duke kujtuar gjithnjë se kishte të bënte me një parti marksiste-leniniste e me një vend socialist, rrjedhimisht duke e mbështetur me zemër të hapur Kinën, në çdo rast u ka vënë në dukje udhëheqësve kinezë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre të gabuara dhe i ka kritikuar ata shoqërisht. Nga këto pozita ajo ka kërkuar që kontradiktat e mosmarrëveshjet të mos trasheshin, por të zgjidheshin në rrugë marksiste-leniniste.

Mirëpo ata, në një kohë kur mirëprisnin dhe lavdëronin me të madhe mbështetjen që u jepte PPSH, nuk i mirëprisnin aspak vërejtjet kritike të saj. Ata nuk i kanë përfillur kritikën që u janë bërë nga PPSH për çështjen e kufijve shtetërorë kino-sovjetikë, për iluzionin që ushqyen me rastin e rrëzimit të Hrushovit, për afrimin me imperialistët amerikanë dhe për vizitën e Niksonit në Kinë. Jo vetëm kaq, por, duke gjykuar me logjikën e partisë së madhe e të shtetit të madh, janë përpjekur t'i imponojnë edhe Partisë së Punës të Shqipërisë pikëpamjet e qëndrimet e tyre antimarksiste. Nga këto pozita nuk i dhanë përgjigje propozimit që bëri KQ i PPSH, në janar 1974, për të dërguar një delegacion të nivelit të lartë në Pekin, që të zhvillonte bisedime rreth çështjeve për të cilat kishte kontradikta e mosmarrëveshje, në një kohë kur në Kinë priteshin e përcilleshin me nderime të jashtëzakonshme nga Mao Ce Duni, Çu En Lai e të tjerë presidentë amerikanë, mbretër e princër, reaksionarë e fashistë të ndryshëm. Udhë-

heqësit kinezë donin që PPSH, përpara se të dërgonte delegacionin e saj, të kishte pranuar pa kushte vijën e tyre.

PPSH qëndronte e palëkundur në parimet marksiste-leniniste e në vijën e vet revolucionare. Pikërisht nga këto pozita ajo kritikoi në Kongresin VII teorinë e «tri botëve», pasi të gjitha përçapjet e saj për diskutim të drejtpërdrejtë me udhëheqësit kinezë nuk kishin gjetur asnjë përgjigje nga ana e tyre. Tashmë PPSH kishte krijuar bindjen e plotë se udhëheqësit kinezë ndiqnin me ndërgjegje një kurs antimarksist, hegjemonist, që po dëmtonte rëndë lëvizjen komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare, gjithë forcat revolucionare botërore.

Dështimi i udhëheqësve kinezë për të nënshtruar PPSH, guximi i saj për të kundërshtuar vijën e tyre, vendosmëria e saj për të ndjekur në mënyrë të pavarur vijën e vet revolucionare, këto përbëjnë shkakun e vërtetë të vendimit, për t'i prerë kreditë e ndihmat Shqipërisë.

Letra e KQ të PPSH i bënte të njohur opinionit botëror edhe të vërtetën në marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-kineze.

Faktet kishin nxjerrë në shesh shumë qartë, vitet e fundit, se kreditë e ndihmat nga Kina nuk jepeshin në frymën e internacionalizmit proletar, siç kishin kujtuar PPSH e populli shqiptar. Ato kishin qëllime të mbrapshta, për ta kthyer Shqipërinë në një vend vasal të Kinës, në një bazë ekspansioni të saj në Evropë.

Letra sqaronte gjithashtu se ato ndihma s'qenë lëmosha, por kredi, detyrime të dyanshme që rridhnin nga marrëveshjet zyrtare, të përfunduara sipas dëshirës dhe interesave të njëjës e tjetrës palë, në përputhje me praktikën ndërkombëtare të marrëdhënieve midis shteteve sovraane.

Duke prerë ndihmën ekonomike dhe ushtarake, udhëheqja kineze mendonte, siç patën menduar në kohën e vet edhe hrushovianët, se Shqipëria socialiste ose do të gjunjëzohej e do t'i nënshtrohej asaj ose do t'u shitej fuqive të tjera të mëdha. Partia e Punës i përgjigjej asaj: «Shqipëria kurrë nuk do të dorëzohet te kurrkush, ajo do t'i qëndrojë deri në fund besnike marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar, do të marshojë pa u ndalur në rrugën e socializmit e të komunizmit...»¹.

1 Letër e KQ të PPSH dhe e Qeverisë së RPSSH, drejtuar KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze, 1978, f. 46.

3. FORCIMI I GJITHANSHËM I GJENDJES SË BRENDSHME TË VENDIT

Partia nuk i fshihte as nuk i nënvleftësonte vështirësitë që rrodhën nga prerja e kredive kineze, nga veprimtaria armiqësore antishqiptare në përgjithësi e udhëheqësve kinezë. Por këto vështirësi nuk çuan në ndonjë krizë ose në dobësimin sadopak të gjendjes së brendshme, siç synonin revizionistët kinezë, siç dëshironin edhe imperialistët amerikanë me socialimperialistët sovjetikë për të shfrytëzuar gjendjen e rëndë që do të krijohej në Shqipëri në dobi të planeve të tyre kundërrevolucionare dhe ekspansioniste. Kjo nuk ndodhi sepse Partia e kishte përgatitur me kohë veten e popullin, nga çdo pikëpamje, për të mos u zënë në befasi, për t'i bërë ballë çdo situatë, për plotësimin e detyrave të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së vendit.

Lufta për plotësimin e detyrave ekonomike

Kujdesi i Partisë për zbatimin e vendimeve të Kongresit VII u shtri në të gjitha fushat e drejtimet, veçanërisht në fushën e ekonomisë. Duke argumentuar këtë qëndrim të Partisë, shoku Enver Hoxha thoshte: «Si-kurse dihet, frontin kryesor të ndërtimit socialist e përbën ekonomia, zhvillimi i së cilës në stadin e sotëm të zhvillimit dhe në kushtet aktuale ndërkombëtare, është bërë më i ndërlikuar dhe më i vështirë»¹. Një ekonomi e fortë përbën gjithnjë shtyllën kurrizore të rendit socialist, kurse në rrethanat konkrete, më shumë se në çdo situatë tjetër, plotësimi i detyrave ekonomike dëshmonte për forcën e pamposhtur të këtij rendi në përgjithësi, të diktaturës së proletariatit në veçanti, për vijën e drejtë të Partisë e për lidhjet e çelikta të saj me masat, për shkallën e ndërgjegjes socialiste të tyre, siguronte edhe një mbrojtje të pathyeshme.

Për zhvillimin e ekonomisë së saj socialiste, RPSSH tanimë s'merrte asnjë kredi e ndihmë materiale të jashtme. Dhe kjo ndodhte në kushtet e krizës së rëndë ekonomiko-financiare të botës kapitaliste si edhe të bllokadës së egër imperialisto-revizioniste.

¹ Enver Hoxha. Fjala në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH, 15 janar 1980, AQP.

Imperialistët, revizionistët, gjithë reaksioni botëror filuan të bënin zhurmë duke e quajtur të pamundur që Shqipëria të ecte përpara vetëm me forcat e veta. Ajo do të detyrohej, thoshin ata, t'i nderë dorën Bashkimit Sovjetik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose Evropës Perëndimore! Por Shqipëria socialiste do të tregonte me shembullin e vet se pa kredi e ndihmë të shteteve kapitaliste e revizioniste mund të jetohet shumë mirë dhe të ecet me siguri përpara. Vështirësitë ishin shumë të mëdha, por pikërisht në situata të vështira, më shumë se çdo herë tjetër, provohet forca e pathyeshme e rendit socialist, e popullit të lirë e sovran, e partisë marksiste-leniniste.

Vështirësitë u përballuan, përveç të tjerave, me një përdorim më të përsosur të të gjitha mjeteve materiale, të aftësive prodhuese e të rezervave. Organizatat e partisë, organet e pushtetit e të ekonomisë, kuadrot, punonjësit u vunë në pozita më luftarake, duke treguar më tepër mprehtësi, këmbëngulje, guxim në mendime e veprime, duke forcuar disiplinën në punë, duke luftuar më me vendosmëri të metat, gabimet, shfaqjet e huaja, duke zgjidhur më shpejt e më mirë problemet e ndryshme të prodhimit e të shërbimeve.

Me thirrjen e Partisë, punonjësit e degëve, të sektorëve, të ndërmarrjeve të ndryshme morën një varg iniciativash dhe iu përveshën punës: për ndërtimin me forcat e veta të veprave që u lanë pa përfunduar nga prerja e kredive kineze; për të prodhuar në vend shumë pjesë ndërrimi e artikuj të tjerë të rinj, që më parë importoheshin, pajisje e makineri të plota për industrinë, për bujqësinë, për ndërtimin etj.; për të përsosur teknologjinë, për të shfrytëzuar më gjerësisht aftësitë prodhuese e për të rritur efektivitetin e investimeve; për të bërë më shumë kursime; për ta çuar në përgjithësi përpara prodhimin.

Si rrjedhim, me gjithë vështirësitë që krijoi prerja e kredive kineze, produkti i përgjithshëm shoqëror e prodhimi industrial më 1979 e 1980, dy vitet e para të zhvillimit të ekonomisë popullore pa asnjë ndihmë materiale të jashtme, u shtuan me një ritëm mesatar vjetor përkatësisht 4,9 e 6,6 për qind, kundrejt 4,2 e 5,7 për qind më 1976-1978.

Përfunduan dhe u vunë në shfrytëzim një pjesë e mirë e kombinatit «Çeliku i Partisë» në Elbasan, hidrocentrali «Drita e Partisë» në Fierzë, Uzina e Përpunimit të Naftës në Ballsh,

një uzinë tjetër mekanike e disa reparte të reja në kombinatin e autotraktorëve «Enver Hoxha» në Tiranë, Fabrika e Letrës në Lezhë, Miniera e Qymyrgurit në Valias, Uzina e Ferrokromit në Burrel, Uzina e Pirometalurgjisë në Laç, Hekurudha Përrenjas-Guri i Kuq etj. Me ndërtimin e këtyre veprave u krijuan baza të reja të rëndësishme për zhvillimin e pavarur të ekonomisë nga importi. Gjatë viteve 1979-1980 u prodhuan lart nga 25 000 artikuj të rinj, rreth 350 linja, reparte e fabrika të reja. U plotësua dhe u tejkalua detyra që i kishte vënë industrisë Kongresi VII i Partisë për të prodhuar 95 për qind të pjesëve të ndërrimit. Të gjitha këto janë fryt i mundit dhe i mendimit krijues të punëtorëve, të kuadrove e specialistëve shqiptarë.

Duhet mbajtur parasysh se këto arritje u siguruan edhe në një kohë kur shtetit e popullit shqiptar iu desh të bënin shpenzime të mëdha të paparashikuara e të zinin me punë të posaçme shumë forca për zhdukjen brenda 5-6 muajve, pa asnjë ndihmë të jashtme, të pasojave të tërmetit të prillit 1979 në Shkodër, Lezhë e rrethe të tjera të Veriut. Puna për zhdukjen e pasojave të tërmetit përbënte njëkohësisht një shprehje të unitetit të çeliktë të popullit rreth Partisë, të vitalitetit të rendit socialist.

Ndërkaq, bujqësia vazhdoi të siguronte në vend çdo vit nevojat në drithëra për bukën e popullit, për industrinë e blegtorinë dhe për rezerva.

Një punë të madhe kryen Partia e shteti për të përballuar vështirësitë që u krijuan në Tregtinë e Jashtme, për të zhdukur çrregullimin që u krijua në import-eksportin, 40 për qind e vëllimit të të cilit kryhej më parë me Kinën. Si rrjedhim, u bënë hapa të rëndësishëm në realizimin e kthesës që kërkonte Partia me këtë rast, duke çarë me guxim e shkathtësi në tregun ndërkombëtar mbi bazën e parimit «shit e bli pa kredi». Kjo sigurisht nuk ishte një punë e lehtë në kushtet e bllokadës e të krizës ekonomiko-financiare të botës kapitaliste.

Për sa i përket planit pesëvjeçar në përgjithësi, pavarësisht se disa tregues të këtij plani në degë e sektorë të ndryshëm të ekonomisë nuk u arritën, disa vepra industriale nuk u ndërtuan në afatet e caktuara për shkak të prerjes së kredive dhe për arsye të tjera, detyra kryesore e tij «vazhdimi me ritme të shpejta i ndërtimit socialist të vendit» përgjithësisht

u plotësua. Ritmi mesatar i shtimit të prodhimit shoqëror dy-tri herë më shpejt se rritja e popullsisë (i realizuar në këto 20 vjet, që nga viti 1960) u ruajt. Prodhimi industrial u shtua me një ritëm mesatar vjetor prej 6,1 për qind, kurse prodhimi mesatar vjetor i realizuar në bujqësi gjatë pesëvjeçarit të 6-të ishte 22 për qind më i lartë se prodhimi mesatar i realizuar në pesëvjeçarin e pestë.

Në përputhje me zhvillimin e forcimin e bazës materialo-tekniqe, të forcave prodhuese në përgjithësi, u zhvillua dhe u forcua edhe baza ekonomike e socializmit, u përsosën më tej marrëdhëniet socialiste në prodhim.

PPSH kurrë nuk ka lejuar të krijohet hendek midis njërës dhe tjetrës anë të mënyrës socialiste të prodhimit, të lindë konflikt nga kontradiktat (joantagoniste) që ka e do të ketë gjithnjë midis marrëdhënieve socialiste në prodhim e forcave prodhuese. Nga pesëvjeçari në pesëvjeçar, krahas zhvillimit të forcave prodhuese, janë marrë masa për zhvillimin e përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve në prodhim, në fushën e pronës, të shpërndarjes, të qarkullimit, të drejtimit. Kështu, duke mos qëndruar në vend, duke shkuar gjithnjë përpara, në përputhje me zhvillimin e forcave prodhuese, marrëdhëniet në prodhim kanë shërbyer si forcë e madhe lëvizëse për të çuar përpara bazën materialo-tekniqe të socializmit, shoqërinë socialiste në përgjithësi.

Ndër masat më të rëndësishme që mori Partia për përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim në pesëvjeçarin e 6-të është kufizimi i oborrit dhe tufëzimi i bagëtive të familjeve kooperativiste.

Oborri, si pronë vetjake, si burim plotësues të ardhurash i familjes kooperativiste, ka pësuar vazhdimisht ndryshime krahas fuqizimit të kooperativave. Me forcimin dhe me zhvillimin e pronës kooperativiste, me shndërrimin gradual të saj në pronë të të gjithë popullit, oborri e humbet funksionin e qëllimin, për të cilin është krijuar, shkon drejt venitjes deri në shuarjen e tij të plotë, kur të gjitha nevojat do t'i plotësohen fshatarit nga prona e përbashkët.

Pikërisht nga ky orientim u nis KQ i Partisë që mori vendimin, në nëntor 1980, për kufizimin e mëtejshëm të oborrit të familjes kooperativiste, për të zhdukur kontradiktën serioze të krijuar midis oborrit dhe pronës kooperativiste me zhvillimin e kësaj të fundit. Kjo masë shërben për afrimin e obo-

rrit, si pronë vetjake, me pronën kolektive, zgjeron kushtet për shndërrimin e tij shkallë-shkallë në pronë të të gjithë popullit; lidh më tepër interesin vetjak të fshatarit me interesin e përgjithshëm në dobi të këtij të fundit; ndihmon në plotësimin më mirë të nevojave materiale të familjeve kooperativiste; i lidh më ngushtë fshatarët me pronën e punën kolektive, si ekonomikisht ashtu edhe moralisht.

Një masë tjetër e Partisë ka të bëjë me përsosjen e shpërblimit sipas punës. Në bazë të kësaj mase, shpërblimi lidhet jo vetëm ose kryesisht me sasinë, por edhe me cilësinë e shpenzimit e prodhimit. Të tre këta tregues merren si bazë në shpërblimin e gjithë punonjësve të prodhimit.

Por arritjen më të rëndësishme në pesëvjeçarin e 6-të e përbëjnë krijimi i një baze të fuqishme materiale, fitimi i një përvoje të gjerë prodhimi, drejtimi dhe organizimi për të kaluar në pesëvjeçarin e 7-të me një siguri të madhe. U zbuluan fusha të reja naftë e gazmbajtëse, vendburime të reja minerale, u zgjeruan vendburimet e mëparshme, u kryen studime e u bënë përgatitje për ngritje fabrikash të reja pasurimi të mineraleve, për ndërtimin e centraleve të reja elektrike, të uzinave, fabrikave e reparteve të reja të prodhimeve të ndryshme industriale, për një përqendrim të mëtejshëm të prodhimit bujqësor. U kryen studime dhe u bënë përgatitje për zgjidhjen edhe të një vargu problemesh që kanë të bëjnë me zhvillimin e forcave prodhuese në industri, në ndërtim, në transport, në bujqësi, gjithashtu me përsosjen e marrëdhënieve në prodhim (zhvillimin e fuqizimin e pronës socialiste, përsosjen e shpërndarjes e të qarkullimit, përmirësimin e drejtimit me plan të ekonomisë).

Plani i 7-të pesëvjeçar është pesëvjeçari i parë i zhvillimit të ekonomisë e të kulturës pa asnjë kredi e ndihmë materiale të jashtme. Burimet materiale e të ardhurat e përgjithshme financiare për këtë pesëvjeçar, është llogaritur të jenë më të mëdha se në çdo pesëvjeçar tjetër, duke përfshirë edhe kreditë e jashtme të përdorura.

Rritja e fuqisë mbrojtëse të atdheut

min e të gjitha detyrave të

Situata e krijuar bënte të domosdoshme të tregohej një kujdes shumë i madh për plotësimin e të gjitha detyrave të

caktuara nga Partia për mbrojtjen e atdheut.

Këtë situatë do të përpiqeshin ta shfrytëzonin fuqitë imperialiste, sidomos SHBA dhe BS, për qëllimet ekspansioniste e grabitqare në kuadrin e planeve të tyre strategjike në Ballkan e në Evropë. Superfuqitë synojnë Shqipërinë jo vetëm për pozitën e saj strategjike në Adriatik e në Mesdhe, por edhe për të asgjësuar këtu socializmin e pavarësinë e plotë kombëtare, që shërbejnë si shembull frymëzimi për forcat revolucionare e popujt liridashës të botës.

Plenumi i 5-të i KQ të PPSH, që shqyrtoi çështjen e forcimit të mëtejshëm të mbrojtjes së vendit në situatën aktuale, udhëzonte: «Ne duhet të jemi plotësisht të përgatitur për të përballuar çdo situatë. Dhe pikërisht këtë po bëjmë. Prandaj të mos krijojmë iluzione nga gjendja relativisht e qetë që është sot rreth kufijve të vendit tonë, por të jemi gjithmonë vigjilentë dhe të përgatitemi për mbrojtjen e atdheut nga një agresion i jashtëm edhe në kushtet më të vështira për ne, sipas variantit më të vështirë, sikurse përcaktohet nga vija ushtarake e Partisë»¹.

Plenumi vërente se kthesa që duhej bërë në çështjen e mbrojtjes pas shkatërrimit të grupit armiqësor të kryesuar nga B. Balluku, «është bërë e plotë, sipas kërkesave të vijës së Partisë». Përparimet qenë shumë të mëdha. Gatishmëria luftarake e ushtrisë dhe e mbarë popullit për t'i bërë ballë një agresioni të armatosur armik, nga çdo anë dhe në çdo kohë që të vinte, ishte e lartë.

Në bazë të konkluzioneve dhe të orientimeve të Plenumit, në vazhdim të direktivave të mëparshme të Partisë, veçanërisht të Kongresit VII të saj, për mbrojtjen, vëmendja e organeve dhe organizatave të Partisë në ushtri e në terren u përqendrua sidomos në disa çështje themelore.

Përvoja më se tridhjetëvjeçare pas Çlirimit kishte treguar se mbrojtja e një vendi varet nga gjendja e brendshme e tij. Çdo fuqi imperialiste ose socialimperialiste, pa përjashtim, ka plane të posaçme strategjike për sulme e pushtime në njërin ose tjetrin vend, në njërën ose tjetrën zonë e rajon, në njërën ose tjetrën situatë. Por këto plane realizohen vetëm kur gjen-

1 Raport i Byrosë Politike paraqitur në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH, 26 qershor 1978, AQP.

dja në vendin që sulmohet e pushtohet është e dobët nga pikëpamja politike, ekonomike, morale e ushtarake.

Prandaj një drejtim kryesor ku përqendroi vëmendjen Partia ishte sqarimi më i madh dhe kuptimi më i thellë i rolit vendimtar të faktorit të brendshëm, i luftës për forcimin e gjithanshëm të gjendjes së brendshme, për përgatitjen sa më të lartë e të plotë të ushtrisë e të mbarë popullit të armatosur për mbrojtjen.

Me këtë nuk nënvleftësohet faktori i jashtëm, mbështetja e fuqishme e forcave përparimtare e liridashëse të botës dhe e lëvizjes marksiste-leniniste ndërkombëtare, që i jepet Shqipërisë socialiste dhe që do t'i jepet edhe më shumë në rast agresioni imperialisto-revizionist kundër saj. Por kjo mbështetje e jashtme e bën efektin e saj të madh vetëm kur është e shëndoshë dhe e qëndrueshme gjendja e brendshme e vendit, kur është në lartësinë e duhur faktori i brendshëm.

Nga puna për të vënë në jetë idetë dhe vendimet e Kongresit VII, orientimet e KQ, mësimet e shokut Enver Hoxha, mori një kuptim më të thellë, më të plotë, më konkret përcaktimi që i bën Partia mbrojtjes së atdheut si detyrë mbi detyrat.

Historia ka vërtetuar se çdo gjë që krijohet e fitohet me djersë e me gjak duhet mbrojtur po me djersë e me gjak.

Lufta për të fituar lirinë e pavarësinë, për të ndërtuar socializmin është e pandarë nga lufta për t'i mbrojtur ato. Në të vërtetë s'ka dy, por një luftë të vetme.

Lidhur me këtë Partia luftoi çdo gjurmë të kuptimit të ngushtë të mbrojtjes që e redukton atë vetëm në stërvitjen dhe çështjet e tjera ushtarake, kuptim që e patën kultivuar tradhtarët B. Balluku me shokë për qëllimet e tyre armiqësore. U bë edhe më e qartë për të gjithë se sa më mirë të plotësohen planet ekonomike, sa më i shëndoshë të jetë rendi shoqëror socialist, sa më të fortë të jenë diktatura e proletariatit dhe uniteti Parti-popull, sa më të përgatitur të jenë njerëzit nga pikëpamja politike, ideologjike, kulturore-arsimore e teknike, aq më e fortë është mbrojtja e vendit.

Njëkohësisht Partia e rrënjosi më thellë në mendje të punonjësve se mbrojtja bëhet me armë në bazë të artit ushtarak të luftës popullore. Po s'u zotërua ky art dhe përdorimi në mënyrë të përsosur i armëve dhe i teknikës luftarake në tërësi, nuk mposhtet agresori. Lidhur me këtë, ajo zhvilloi një punë

të madhe për një kuptim më të thellë të kërkesave të luftës popullore, për studimin e përvetësimit me shpirt krijues të artit të kësaj lufte.

Ndërthurjes organike të detyrave ushtarake dhe detyrave ekonomike, politike, ideologjiko-shoqërore, kulturore, si pjesë të një çështjeje të vetme, i shërbeu forcimi i mëtejshëm i lidhjeve e i bashkëpunimit midis organizatave të partisë në terren e në ushtri, midis organeve të pushtetit, ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore dhe komandave të njësive e reparteve.

Si pasojë e realizimit të udhëheqjes unike të çështjeve të mbrojtjes nga ana e Partisë dhe e kujdesit të vazhdueshëm nga të gjithë për mbrojtjen, gjetën zgjidhje më të mirë një varg problemesh të stërvitjes, të fortifikimit, të pajisjes me teknika moderne ushtarake, të gatishmërisë luftarake të të gjitha armëve, të të gjitha strukturave të mbrojtjes, të mbarë popullit ushtar dhe u shënuan arritje të papara ndonjëherë.

Këto përparime vërtetojnë drejtësinë e vendimeve e të masave që ka marrë Partia për forcimin dhe revolucionarizimin e vazhdueshëm të forcave të armatosura e të përgatitjes për mbrojtje në përgjithësi.

Përsosja e drejtimit dhe e organizimit shkencor. Thellimi i punës kërkimore-shkencore

fort pas drejtimit dhe organizimit shkencor të punëve, duke e quajtur përsosjen e tyre «një halkë nga më vendimtarët». Arritjen e këtij qëllimi ajo e lidhi me thellimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Zhvillimi ekonomiko-shoqëror e kulturor i vendit kishte arritur një shkallë mjaft të lartë. Qe ndërtuar një ekonomi shumëdegëshe dhe komplekse, zhvillimi intensiv i së cilës nuk mund të kryhet pa u mbështetur fort në shkencën, në tekniken, në teknologjinë dhe në metodat e përparuara, pa njohur dhe zbatuar ligjet e shkencës. Në përputhje me zhvillimin e forcave prodhuese, qenë thelluar e duhej të thelloheshin edhe më shumë marrëdhëniet socialiste në prodhim. Në lidhje organike me to, ishin bërë ndryshime të mëdha, që duhej të çoheshin vazhdimisht përpara, në ndërgjegjen socialiste të masave, në psikologjinë e tyre të punës, të pronës, të mënyrës së jetesës. Veç këtyre, Shqipëria ndërtonte shoqërinë e plotë

socialiste duke qenë e rrethuar nga bota kapitalisto-revizioniste dhe pa asnjë ndihmë ekonomike e kredi të jashtme.

Ishin pikërisht këto kushte objektive që lypnin përsosjen e drejtimit dhe të organizimit shkencor të punëve, thellimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Në të tilla kushte s'mund të drejtohet në mënyrë empirike, me koncepte e praktika të vjetra artizanale. Kudo kërkohen kulturë, dije të gjera, studime të thella, disiplinë e fortë shkencore.

Këto çështje kaq të rëndësishme u morën në shqyrtim në Plenumin e 7-të e në Plenumin e 8-të të KQ (janar e qershor 1980), që plotësojnë njëri-tjetrin.

Në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror u zhvillua një luftë e gjithanshme për ta ngritur punën e Partisë e të shtetit në një nivel më të lartë shkencor.

Për këtë, iu kushtua një vëmendje e madhe zhdukjes së shfaqjeve të subjektivizmit e të voluntarizmit dhe mbështetjes më fort të punës drejtuese dhe organizuese në ligjet e materializmit dialektik e historik dhe të ekonomisë politike marksiste-leniniste, në ligjet ekonomike objektive të shoqërisë socialiste, si edhe në ligjet e shkencave të natyrës. Këto ligje janë të hekurta, mëson Partia, dhe mosnjohja e moszbatimi i tyre janë me pasoja të rënda, që bëhen tepër të rrezikshme për shoqërinë socialiste.

Partia kërkoi prej të gjithëve të mbaheshin parasysht më mirë sidomos disa ligjësi të prodhimit. Plani nuk është vetëm prodhimi global, por edhe rendimenti, edhe kostoja, edhe cilësia, edhe asortimenti, edhe akumulimi, edhe eksporti etj. Këto është e nevojshme të realizohen medoemos një për një, ndryshe ndodhin çrregullime që mund të bëhen të pandreqshme. Në bazë të ligjësisve të prodhimit socialist, pjesa më e madhe e shtesës së produktit shoqëror duhet të vijë nga rritja e rendimentit të punës dhe jo nga shtimi i numrit të punonjësve; produkti për shoqërinë të rritet më shpejt se produkti për vete; rendimenti i punës të rritet më shpejt se të ardhurat reale për frymë të popullsisë. Vetëm kështu sigurohen riprodhimi i zgjeruar socialist, rritja e vazhdueshme e mirëqenies së popullit, zhvillimi me ritme të shpejta i ndërtimit socialist. Duke kërkuar zbatimin e këtyre ligjeve në kushtet konkrete të ndërtimit socialist të vendit, Partia tërhoqi vëmendjen për t'u dhënë një zgjidhje më të plotë e më të mirë përdorimit racional dhe kursimit të punës së gjallë e të vlerave mate-

riale, problemeve financiare, sigurimit të burimeve të brendshme të akumulimit, efektivitetit të prodhimit shoqëror, shfrytëzimit sa më të plotë të aftësive prodhuese ekzistuese, rritjes së rendimentit e uljes së kostos, rentabilitetit të ndërmarrjeve, zënies me punë të forcave të reja që krijohen çdo vit etj.

Drejtimi shkencor i prodhimit zë fill që nga planifikimi shkencor. Jeta nxori domosdoshmërinë e përsosjes së mëtejshme të metodologjisë së planifikimit mbi bazën e përvojës së grumbulluar për këtë çështje madhore, të përmirësimit të punës planifikuese duke zhdukur shfaqjet e globalizmit e duke thelluar planifikimin e prodhimit në natyrë, duke pasqyruar e materializuar më mirë në plan lidhjet e bashkëpunimit e të kooperimit midis degëve e sektorëve të ekonomisë në shkallë kombëtare, midis rretheve, midis ndërmarrjeve e kooperativave, si edhe duke siguruar një harmonizim më të drejtë ndërmjet treguesve ekonomikë, teknikë e financiarë të planit.

Në mënyrë të veçantë Partia nguli këmbë për një unitet të plotë midis planit dhe plotësimit të tij, si edhe plotësimit të çdo detyre në çdo hallkë të zinxhirit të planit, si plan unik shtetëror.

Plani unik shtetëror kërkon edhe një drejtim shtetëror unik të ekonomisë mbi bazën e centralizmit demokratik. Këtë drejtim unik s'mund ta cenojë organizimi i ekonomisë sipas degëve e sektorëve, sipas llojit të prodhimit e sipas rretheve. Në bazë të këtij orientimi të Partisë, lufta u zhvillua kundër shfaqjeve që dëmtonin drejtimin unik shtetëror të ekonomisë, si zbatimi jo i përpiktë i ligjeve, i urdhëresave dhe i rregullave të caktuara, praktikave e gabuara të shikimit të gjërave nga prizmi i interesave të ngushta të dikasterit, të sektorit, të rrethit, të ndërmarrjes e kooperativës, për një bashkëpunim, bashkërendim e kooperim të shëndoshë, të sinkronizuar, të vazhdueshëm. Këshilli i Ministrave u ngarkua të realizojë më mirë në shkallë kombëtare drejtimin unik shtetëror.

Për të përmirësuar drejtimin e organizimin shkencor të punëve rëndësi të madhe i kushtoi Partia pjesëmarrjes më të gjerë të masave punonjëse në këtë çështje mbi bazën e bindjes së thellë të tyre në drejtësinë e vijës, të direktivave të Partisë, të planeve të shtetit, në zbatueshmërinë e detyrave. Nga praktika dilte se mjaft detyra të planit në njërën ose tjetrën ndërmarrje e kooperativë nuk zbatoheshin plotësisht sepse masat

nuk qenë bërë sa duhet të ndërjegjshme për ato detyra. Ky ishte shkak edhe i mjaft shfaqjeve të thyerjes së disiplinës në punë, të dëmtimit e shpërdorimit të pronës së përbashkët, të indiferentizmit. Lidhur me këtë u dhanë udhëzime e u morën masa për një punë më të shëndoshë e më të frytshme ideopolitike, të shoqëruar me masa tekniko-ekonomike e organizative. U kritikuan shfaqjet e zgjidhjes së problemeve vetëm nga lart dhe u lidh më mirë lufta nga lart me luftën nga poshtë, të vetë masave të organizuara, kusht i domosdoshëm ky për një drejtim shkencor të punëve, për plotësimin e detyrave. Kjo bënte të domosdoshme edhe përsosjen e punës së organizatave shoqërore, si leva të fuqishme të Partisë për bindjen e njerëzve e për mobilizimin e tyre mbi bazën e këtyre bindjeve, për zbatimin e direktivave, të ligjeve, të detyrave.

Drejtimi dhe organizimi shkencor i punëve kërkon, midis të tjerave, që çdo organ e çdo organizatë partie, çdo hallkë e sistemit administrativ shtetëror, çdo kolektiv punonjës, çdo komunist e çdo kuadër të kryejë detyrën e ngarkuar me ndjenjën e përgjegjësisë më të lartë, me iniciativë, me kompetencë e me mjeshtëri. Partia ka kritikuar gjithnjë, ajo kritikoi edhe më fort në kushtet konkrete shfaqjet e pritjes së udhëzimeve nga lart për të filluar punën e për të zbatuar detyrat, po ashtu edhe shfaqjet për t'ia lënë punën e përgjegjësinë tjetrit. «Secili duhet të kryejë me devotshmëri e kompetencë detyrën e tij, — theksonte shoku Enver Hoxha, — dhe jo ca të punojnë e ca të rrinë në hije»¹. Por ajo nuk la pa kritikuar edhe ata kuadro drejtues që mundohen t'i kryejnë të gjitha punët vetë, që merren me çdo gjë nga pak, në vend që të venë në lëvizje çdonjërin të kryejë detyrën e të përgjigjet për punën e tij, si edhe ato komitete partie e komitete ekzekutive rrethesh që përpiqen të zgjidhin problemet e bazës vetëm nga lart duke dërguar ekupe pas ekipesh, duke ngritur shtabe pas shtabesh, në vend që të kërkojnë e të ndihmojnë që baza t'i zgjidhë ato vetë, që të aktivizohen me të gjitha forcat organet e njerëzit e zgjedhur, organizmat ekzistuese dhe organizatat e masave, në vend që të bëjnë çdo organizatë-bazë të kryejë plotësisht rolin udhëheqës.

¹ Enver Hoxha. Fjala në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH. 15 janar 1980. AQP.

Përmirësimi të drejtimit e të organizimit të punës i shërbeu revolucionarizimi i mëtejshëm i kontrollit të zbatimit të vendimeve, të direktivave, të detyrave. Duke kërkuar forcimin e kontrollit, Partia e bëri edhe më të qartë se nuk ka aq rëndësi numri i kontrolleve sa ka rëndësi çfarë kontrolli ushtrohet: kontroll revolucionar që zbulon të metat e dobësitë dhe ngre më këmbë komunistët, kuadrot, punonjësit në luftë të papajtueshme kundër tyre për plotësimin e detyrave apo kontroll burokratik e liberal, që kapet pas cikërrimave dhe nuk zbulon e nuk ndryshon asgjë. Ndërkohë që kontrolli punëtor e fshatar u përsos më tej, Komiteti Qendror i Partisë u doli përpara keqkuptimeve dhe u preu rrugën praktikave të gabuara që rrezikonin zëvendësimin e kontrollit të partisë e të kontrollit shtetëror me kontrollin punëtor e fshatar, duke siguruar zbatimin më mirë të direktivës për këtë të fundit.

Në kuadrin e përsosjes së drejtimit dhe të organizimit shkencor të punëve, Partia i dha një zhvillim të mëtejshëm metodës së përhapjes së përvojës së përparuar, duke e bërë këtë punë më sistematike e të studiuar. U ngritën për këtë qëllim edhe shkollat e përhapjes së përvojës së përparuar në rrethe, ndërmarrje e kooperativa, disa edhe në shkallë kombëtare.

Përsosjes së drejtimit dhe organizimit shkencor do t'i shërbente zhvillimi më gjerë e më thellë i vetë shkencës, i veprimtarisë kërkimore-shkencore. «...Nuk ka e nuk mund të ketë drejtim e organizim shkencor, — theksonte shoku Enver Hoxha, — pa studime të thelluara e të gjithanshme aktuale e perspektive, pa përgjithësime e analiza shkencore»¹.

Komiteti Qendror i Partisë mori vendime e caktoi detyra konkrete për thellimin e punës kërkimore-shkencore.

Për shkencat teknike e natyrore ai shtroi detyrë themelore zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor sidomos në dobi të rritjes së prodhimit; zbulimin e përpunimin e lëndëve të para, të lëndëve djegëse e të materialeve të tjera; krijimin e rezervave sa më të mëdha të këtyre lëndëve e materialeve; përsosjen e vazhdueshme të teknologjisë së prodhimit; ruaj-

1 Enver Hoxha. Fjala në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH. 15 janar 1980. AQP.

tjen, shtimin, pasurimin e shfrytëzimin intensiv të tokës, përmirësimin racor e rritjen e prodhimit të blegtorisë etj.

Shkencave shoqërore iu caktua si objektiv kryesor të zhvillojnë më tej, mbi bazën e marksizëm-leninizmit, mendimin krijues revolucionar, të përgjithësojnë përvojën e pasur të revolucionit, të ndërtimit socialist e të mbrojtjes, të përballojnë me guxim problemet e mëdha që nxjerr jeta dhe të argumentojnë shkencërisht perspektivat e zhvillimit të vendit në rrugën e socializmit. Kjo do të thotë që ato të orientohen në radhë të parë nga tematika aktuale, nga problemet që kërkojnë zgjidhje.

Çështjet bashkëkohore, udhëzoi Komiteti Qendror, është e nevojshme të vendosen edhe në qendër të shkencave që studiojnë historinë, gjuhën e kulturën e popullit shqiptar. Por kjo nuk do të thotë që të lihen pas dore studimet për vlerat historiko-kulturore të popullit në shekuj.

Për të siguruar një drejtim, organizim e bashkërendim më të përsosur të veprimtarisë kërkimore e të forcave shkencore në shkallë kombëtare, në bazë të vendimit të Plenumit të KQ, u krijua Komiteti i Shkencave dhe i Teknikës pranë Këshillit të Ministrave.

Komiteti Qendror ngarkoi organet dhe organizatat e partisë të tregojnë një kujdes më të madh për shkencën e punën kërkimore-shkencore, që të kuptohet thellë e të vlerësohet drejt nga të gjithë dobia shumë e madhe që ka socializmi e mbrojtja nga kjo punë, që të zbatohen kudo ligjet e shkencave, të futen gjerësisht metodat e reja dhe teknologjia e përparuar në prodhim, që të ngrihen në një shkallë të lartë shkencore drejtimi e organizimi i punëve.

Ai kërkoi që edhe vetë organet dhe organizatat e partisë të kryejnë studime në lidhje me punën drejtuese, edukuese dhe organizative të partisë. Puna e Partisë, mëson shoku Enver Hoxha, është shkencë e një nga shkencat më të përparuara. Ajo është çelës për zgjidhjen e të gjitha problemeve, për kryerjen e të gjitha detyrave. Si e tillë ajo shërben vetëm kur zhvillohet mbi baza shkencore. Studimet për çështje dhe anë të ndryshme të kësaj pune ndihmojnë për të mos lejuar që ajo të kthehet në një punë rutinë, punë burokratike, për t'i dhënë asaj një forcë sa më të madhe bindëse, mobilizuese, shndërruese.